

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. _____
“PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

1. Ky ligj rregullon funksionimin e skemës së sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe shoqëritë e kursim-kreditit, të licencuara në Republikën e Shqipërisë, nivelet e mbulimit, kompensimin e depozitave, përdorimin e fondeve të sigurimit të depozitave për zbatimin e masave, të ndryshme nga kompensimi i depozitave, të përcaktuara në këtë ligj, me qëllim sigurimin e aksesit të depozituesve në depozitat e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.
2. Objektivi publik i skemës së sigurimit të depozitave është të ofrojë mbrojtje për depozituesit në anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave në rast ngjarje sigurimi.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha institucionet e kreditit, shoqëritë e kursim - kreditit, degët e institucioneve të kreditit të një shteti anëtar, ose të një vendi të tretë, si dhe për subjekte të tjera që kryejnë veprimtarinë e pranimit të depozitave, të licencuara dhe mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.
2. Ky ligj nuk zbatohet për degën e institucionit të kreditit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

¹ Ky ligj është përafshuar plotësisht me Direktivën 2014/49/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 16 prill 2014 për skemat e garantimit të depozitave Numri CELEX: 32014L0049, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.173, date 12.6.2014, faqe 149-178 e ndryshuar nga:

- Direktiva 2026/804/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 30 mars 2026, për disa aspekte që ndryshojnë Direktivën 2014/49/BE. Numri CELEX: 32026L0804, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 2026/804, datë 20.4.2026.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akt nënligjor” është akti i Bankës së Shqipërisë për subjektet anëtare të skemës, i dalë në propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.
2. “Akt i Agjencisë” është tërësia e akteve individuale dhe kolektive të Këshillit Drejtues ose Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, në funksion të organizimit të brendshëm të Agjencisë për të përmbushur objektivat publikë të skemës, në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.
3. “Anëtarë të skemës” janë institucionet e kreditit ose shoqëritë e kursim-kreditit, të cilat janë anëtarësuar në skemë me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.
4. “Autoritet kompetent” është autoriteti kompetent kombëtar përgjegjës për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës të institucioneve të kreditit dhe shoqërive të kursim - kreditit në një shtet anëtar ose vend të tretë. Në Republikën e Shqipërisë autoriteti kompetent është Banka e Shqipërisë.
5. “Autoriteti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme” është autoriteti kompetent kombëtar përgjegjës për ushtrimin e funksionit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për institucionet e kreditit. Në Republikën e Shqipërisë autoriteti i ndërhyrjes së jashtëzakonshme është Banka e Shqipërisë.
6. “Autoritet përgjegjës” është autoriteti që administron skemën e sigurimit të depozitave në një shtet anëtar ose vend të tretë. Në Republikën e Shqipërisë autoriteti përgjegjës është Agjencia e Sigurimit të Depozitave.
7. “Degë” ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre, si dhe në legjislacionin për shoqëritë e kursim - kreditit në Republikën e Shqipërisë.
8. “Datë e ngjarjes së sigurimit” është data në të cilën hyn në fuqi vendimi mbi ngjarjen e sigurimit, siç përcaktohet në pikën 20 të këtij neni.
9. “Depozitues” është titullari i një depozite në një anëtar të skemës, ose në rastin e një depozite të përbashkët secili prej titullarëve.
10. “Depozitë” është teprica kreditore, e cila rezulton nga fondet e lëna në një llogari ose nga gjendjet e përkohshme që rrjedhin nga veprimet e zakonshme bankare, të kryera rregullisht nga institucionet e kreditit dhe SHKK-të gjatë aktivitetit të tyre të përditshëm, dhe të cilat institucioni i kreditit ose SHKK-ja duhet t’i ripaguajë sipas dispozitave të një kontrate dhe dispozitave ligjore, duke përfshirë depozitat me afat, llogaritë e kursimit, dhe llogaritë rrjedhëse, por duke përjashtuar tepricën kreditore, ku;
 - a) ekzistenca e saj mund të provohet nga një instrument financiar, siç përcaktohet në legjislacionin që rregullon tregjet e kapitalit, përveç rasteve kur është një produkt kursimi që dëshmohet nga një certifikatë depozite emërore;
 - b) kryegjëja e saj nuk është e pagueshme në vlerë nominale;
 - c) kryegjëja e saj është e pagueshme në vlerë nominale vetëm sipas një garancie ose marrëveshjeje të caktuar të ofruar nga institucioni i kreditit ose një palë e tretë.
11. “Depozita të pranueshme për sigurim” janë depozitat që nuk përjashtohen nga siguri sipas nenit 18 të këtij ligji.
12. “Depozita të siguruara” nënkupton pjesën e depozitave të pranueshme për sigurim, që nuk e kalon nivelin e mbulimit të përcaktuar në nenin 19, pika 1 të këtij ligji, ose sipas rastit, në nenin 19, pika 2 të këtij ligji.
13. “Depozitë e përbashkët” nënkupton një depozitë të hapur në emër të dy ose më shumë depozituesve ose mbi të cilën dy ose më shumë depozitues kanë të drejta të plota që ushtrohen me nënshkrimin e një ose më shumë prej këtyre depozituesve.

14. “Depozitë e padisponueshme” do të thotë një depozitë e detyrueshme për t’u paguar por që nuk është paguar nga një anëtar i skemës, sipas kushteve ligjore ose kontraktuale që zbatohen për të.
15. “Depozita të fondeve të klientëve” ka kuptimin e fondeve që institucioni financiar, në cilësinë e mbajtësit të llogarisë, i depoziton në institucionet e kreditit, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, për llogari të klientëve të tij.
16. “Financimi i terrorizmit” ka të njëjtin kuptim si në nenet 230/a deri në 230/ç të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
17. “Fondet e veta” nënkupton shumën e kapitalit që një anëtar i skemës ka për të mbështetur veprimtarinë e tij, i cili përbëhet nga kapital i nivelit të parë (*Tier 1*) dhe kapital i nivelit të dytë (*Tier 2*).
18. “Institucion krediti” ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre.
19. “Institucion krediti agent” është institucioni i kreditit anëtar i skemës, i cili zgjidhet nga Këshilli Drejtues i Agjencisë për të kryer proceset e pagesës së shumave të kompensimit, në emër të Agjencisë si një agjent pagese.
20. “Ngjarje sigurimi” do të thotë ndodhja e një ose më shumë rrethanave në një anëtar të skemës, në vijim të së cilave merret:
- a) vendimi i Bankës së Shqipërisë për likuidimin e detyruar të një anëtari të skemës;
 - b) vendimi i Bankës së Shqipërisë për padisponueshmërinë e depozitave të një anëtari të skemës.
 - c) vendimi i Bankës së Shqipërisë për transferimin e fondeve nga fondi i sigurimit të depozitave në rast të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në institucionet e kreditit, siç përcaktohet në legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit në Republikën e Shqipërisë.
21. “Mjete financiare të disponueshme” janë mjetet likuide, depozitat dhe tituj me rrezik të ulët, të cilat mund të bëhen likuide brenda afatit të përcaktuar në nenin 26, pika 2 të këtij ligji.
22. “Nivel i synuar i fondit të sigurimit të depozitave” është shuma e mjeteve financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit ose SHKK-të, që duhet të arrihet brenda periudhës së miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, e përcaktuar si përqindje kundrejt totalit të depozitave të siguruara të anëtarëve të skemës.
23. “Paraqitje unike e depozituesit” janë të dhënat e konsoliduara për identifikimin e çdo depozituesi në mënyrë unike, në sistemin e teknologjisë së informacionit të anëtarëve të skemës, nëpërmjet të dhënave të tij identifikuese, ku përcaktohen saktë shuma e agreguar e depozitave të pranueshme për sigurim, si dhe shuma e kompensimit që ky depozitues përfiton nga skema.
24. “Pastrimi i produkteve të veprës penale” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 287 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
25. “Skemë e sigurimit të depozitave” është sistemi për sigurimin dhe kompensimin e depozitave në anëtarët e skemës, i krijuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, që administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, si dhe sisteme të tjera të ngjashme të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian ose të vendeve të treta. Kudo në këtë ligj, skema e sigurimit të depozitave do të quhet “skema”.
26. “Shoqëri e kursim-kreditit” ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin për shoqëritë e kursim-kreditit në Republikën e Shqipërisë. Kudo në këtë ligj, shoqëria e kursim-kreditit do të quhet SHKK.
27. “Shtet anëtar” është shteti anëtar i Bashkimit Evropian dhe një shtet nënshkrues i Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane.
28. “Shtet anëtar i origjinës” është shteti anëtar në të cilin një institucioni krediti i është dhënë licenca për të ushtruar veprimtarinë.

29. “Shtet anëtar pritesë” është shteti anëtar në të cilin një institucion krediti ka një degë ose në të cilin ai ofron shërbime.

30. “Tituj me rrezik të ulët” janë titujt e parashikuar në nenin 55, pika 3 të këtij ligji.

31. “Vend i tretë” është shteti jashtë Bashkimit Evropian, si dhe shteti që nuk është nënshkrues i Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane, në të cilin një institucioni krediti i është dhënë licenca për të ushtruar veprimtarinë. Deri në anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian vend i tretë do të konsiderohet edhe çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

Neni 4

Parimet bazë të skemës

Parimet bazë të skemës janë:

- a) anëtarësimi i detyrueshëm në skemë i institucioneve të kreditit dhe SHKK-ve të licencuara nga Banka e Shqipërisë për pranimin e depozitave në Republikën e Shqipërisë;
- b) financimi i skemës mbi bazën e pagesave nga anëtarët e saj të kontributit fillestar, kontributit vjetor dhe tremujor të primit dhe kontributeve të jashtëzakonshme;
- c) sigurimi i depozitave të depozituesve në institucionet e kreditit dhe SHKK-të;
- ç) transparenca dhe llogaridhënia e Agjencisë në administrimin e skemës.

KREU II

Anëtarësimi dhe përjashtimi nga skema

Neni 5

Autoriteti për miratimin e anëtarësimit në skemë

Agjencia është i vetmi autoritet përgjegjës për miratimin e anëtarësimit në skemë.

Neni 6

Gjuha

Të gjitha subjektet e këtij ligji përdorin gjuhën shqipe në dokumentacionin dhe korrespondencën e mbajtur në Republikën e Shqipërisë në lidhje me sigurimin e depozitave.

Neni 7

Fazat e anëtarësimit në skemë

Anëtarësimi në skemë përbëhet nga dy faza:

- a) dhënien e vërtetimit të përmbushjes së kushteve për anëtarësimin në skemë;
- b) miratimin e anëtarësimit në skemë dhe lëshimin e certifikatës së anëtarësimit në skemë.

Neni 8

Karakteristikat e certifikatës së anëtarësimit në skemë

- 1. Certifikata e anëtarësimit në skemë është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.
- 2. Elementë të detyrueshëm të certifikatës së anëtarësimit në skemë përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

Neni 9

Ndalimet në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit dhe SHKK-ve

1. Asnjë subjekt, emërtimi i të cilit lidhet me fjalën “institucion krediti”, “SHKK” dhe fjalë të tjera të prejdurhura prej tyre, i cili nuk ka marrë vërtetimin e përmbushjes së kushteve për anëtarësimin në skemë, nuk licenohet nga Banka e Shqipërisë.
2. Asnjë subjekt i këtij ligji nuk lejohet të ushtrojë veprimtari në Republikën e Shqipërisë pa certifikatën e anëtarësimit në skemë. E drejta për të filluar aktivitetin e pranimi të depozitave lind vetëm pasi subjekti pajiset me certifikatën e anëtarësimit në skemë, sipas vendimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë.
3. Asnjë subjekt, aktiviteti i të cilit është pezulluar nga Banka e Shqipërisë, nuk mund të anëtarësohet në skemën e sigurimit të depozitave.

Neni 10

Procedura e anëtarësimit në skemë

1. Subjektet që kërkojnë të anëtarësohen në skemë dorëzojnë në Agjenci kërkesën për anëtarësim njëkohësisht me dorëzimin e kërkesës për licencë në Bankën e Shqipërisë.
2. Agjencia i anëtarëson subjektet në skemë, vetëm nëse:
 - a) plotësojnë kushtet teknike dhe organizative për anëtarësim në skemë, të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Banka e Shqipërisë me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.
 - b) paguajnë kontributin fillestar.
3. Agjencia kryen verifikime në vend të plotësimi të kushteve nga subjektet, si dhe mund të kërkojë informacion shtesë nga subjektet që kërkojnë të anëtarësohen në skemë.
4. Agjencia jep vërtetimin e përmbushjes së kushteve për anëtarësimin në skemë, nëse vlerëson se subjekti plotëson kushtet e kërkuara.
5. Procedura, kërkesa, dokumentacioni dhe kushtet për anëtarësimin në skemë rregullohen me aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.
6. Banka e Shqipërisë njofton Agjencinë për miratimin e vendimit për licencimin e subjektit brenda tre ditëve pune nga marrja e këtij vendimi.
7. Këshilli Drejtues i Agjencisë vendos për miratimin e anëtarësimi në skemë dhe për lëshimin e certifikatës së anëtarësimi në skemë, brenda tre ditëve pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Banka e Shqipërisë, sipas pikës 6 të këtij neni. Vendimi i Këshillit Drejtues të Agjencisë për miratimin e anëtarësimi në skemë dhe për lëshimin e certifikatës së anëtarësimi në skemë, përbën bazën për fillimin e sigurimit të depozitave në këtë anëtar të skemës.
8. Vendimi i Këshillit Drejtues të Agjencisë për miratimin e anëtarësimi në skemë dhe lëshimin e certifikatës do të publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, dhe në faqen e internetit të Agjencisë.
9. Në rast bashkimi ose ndarjesh në veprimtarinë e anëtarit, të cilat duhet të pasqyrohen në certifikatën e anëtarësimi në skemë, ndryshimi i certifikatës miratohet brenda 3 ditëve pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Banka e Shqipërisë.

Neni 11

Përfashtimi nga skema dhe revokimi i certifikatës

1. Këshilli Drejtues i Agjencisë përfashton anëtarin nga skema dhe revokon certifikatën e anëtarësimi në skemë, brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit nga Banka e Shqipërisë për:
 - a) vendimin për vendosjen në likuidim të detyruar të anëtarit të skemës;

- b) vendimin për padisponueshmërinë e depozitave në anëtarin e skemës, në rast se revokohet licenca e anëtarit të skemës;
 - c) vendimin për miratimin e bashkimit ose ndarjes së anëtarit të skemës, në rast se revokohet licenca e anëtarit të skemës;
 - ç) vendimin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në një institucion të kreditit, në rast se revokohet licenca e institucionit të kreditit.
 - d) vendimin e miratimit të likuidimit vullnetar të anëtarit të skemës.
2. Vendimi i Këshillit Drejtues të Agjencisë për përjashtimin e një anëtari nga skema përbën bazën për përfundimin e sigurimit të depozitave në këtë subjekt, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 16, pika 3 dhe 4 të këtij ligji.
3. Vendimi i Agjencisë për përjashtimin e anëtarit nga skema publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Neni 12

Regjistri i anëtarëve të skemës

1. Agjencia mban një regjistër për konsultim nga publiku, në të cilin përfshihen të gjithë anëtarët e skemës, të dhënat e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.
2. Ky regjistër përfshin edhe listën e subjekteve të përjashtuara nga skema, sipas vendimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

KREU III

Kërkesat e zbatueshme për anëtarët e skemës

Neni 13

Detyrimet e anëtarëve të skemës

1. Anëtarët e skemës zbatojnë detyrimet e mëposhtme:
 - a) paguajnë kontributin fillestar, kontributin vjetor ose tremujor të primit dhe kontributet e jashtëzakonshme për llogari të fondeve përkatëse të Agjencisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij.
 - b) mbajnë regjistrin elektronik për paraqitjen unike të depozituesit të anëtarit të skemës, në përputhje me përmbajtjen dhe formën e përcaktuar nga Agjencia.
 - c) paraqesin të dhëna, informacione dhe dokumentacion për veprimtarinë e tyre, veçanërisht për llogaritjen e kontributit vjetor ose tremujor të primit, për llogaritjen e kontributit fillestar, të kontributit të jashtëzakonshëm, të dhëna të depozitave të pranueshme për sigurim, të depozitave të siguruara, të depozitave të përjashtuara, si dhe të dhëna të tjera në bazë të kërkesës së Agjencisë.
 - ç) raportojnë në çdo kohë paraqitjen unike të depozituesit, sipas afatit dhe formatit të përcaktuar në kërkesën e Agjencisë.
 - d) krijojnë sisteme administrimi dhe operacionale për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara nga Banka e Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.
 - dh) evidentojnë depozitat e pranueshme për sigurim në një mënyrë që mundëson identifikimin e menjëhershëm të këtyre depozitave.
 - e) evidentojnë depozitat që janë subjekt i masave sanksionuese sipas nenit 26, pika 6 dhe depozitat për të cilat është dhënë vendim gjyqësor i formës së prerë sipas nenit 18, shkronja “c” të këtij ligji.
 - ë) marrin pjesë në ushtrimet e simulimeve në përputhje me nenin 61 të këtij ligji, si dhe paraqesin të dhëna siç kërkohet nga Agjencia për këtë qëllim.

- f) informojnë depozituesit për skemën, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji dhe aktet nënligjore të tij.
- g) njoftojnë Agjencinë për ndryshimet në veprimtarinë e tyre, për të cilat njoftojnë Bankën e Shqipërisë, sipas ligjeve në fuqi.
- gj) respektojnë kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore të skemës.
- h) kryejnë auditimin vjetor lidhur me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, në veçanti mbi saktësinë e raportimit të të dhënave.
- i) miratojnë akte të brendshme për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të tij.
- j) i japin Agjencisë, sipas afatit dhe mënyrës së përcaktuar në kërkesën e saj, të dhëna dhe informacion në lidhje me:
- depozituesit në degët e këtyre anëtarëve, të cilat ushtrojnë veprimtari në shtete të tjera anëtare ose, kur këto depozita sigurohen nga skemat e sigurimit të depozitave të vendeve të treta;
 - depozituesit e këtyre anëtarëve të cilat ushtrojnë veprimtari në shtete të tjera anëtare, në bazë të lirisë të vendosjes dhe të ofrimit të shërbimeve, siç përcaktohet në Titullin V, Kapitulli 3, të Direktivës 2013/36/BE.
- Ky informacion duhet të përcaktojë shtetet anëtare ose vendet e treta në të cilat ndodhen këto degë ose depozitues.

Neni 14

Regjistri elektronik për paraqitjen unike të depozituesit

- Regjistri elektronik për paraqitjen unike të depozituesit është sistemi i teknologjisë së informacionit i anëtarit të skemës, i krijuar në mënyrë të tillë që të sigurojë mundësinë e marrjes së menjëhershme të të dhënave elektronike të depozituesve në çdo kohë, me qëllim identifikimin e tyre dhe përcaktimin e saktë të shumës së kompensimit.
- Banka e Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, miraton me akt nënligjor informacionin që mbahet dhe përpunohet në sistemin e teknologjisë së informacionit të anëtarit të skemës për paraqitjen unike të depozituesit, raportimin e të dhënave në Agjenci, parimet, procedurat dhe rregullat për funksionimin e këtij sistemi të teknologjisë së informacionit, në veçanti lidhur me përgjegjësinë për cilësinë e të dhënave, kontrollet e aksesit, ruajtjen e informacionit, vijueshmërinë e sistemeve, incidentet kibernetike, marrëdhëniet me ofruesit e jashtëm.
- Subjektet që kërkojnë anëtarësim në skemë dhe anëtarët e saj plotësojnë dhe zbatojnë kushtet teknike për krijimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave në funksion të llogaritjes së kontributit vjetor ose tremujor të primit, të kompensimit të depozitave, si dhe të raportimit në Agjenci të informacionit të kërkuar nga kjo e fundit.
- Agjencia zotëron sistemin e saj të teknologjisë së informacionit për raportim dhe kompensim, me qëllim raportimin e informacionit për paraqitjen unike të depozituesve nga anëtarët e skemës, verifikimin e saktësisë së informacionit të raportuar dhe përdorimin e tij në funksion të sigurimit dhe kompensimit të depozitave. Banka e Shqipërisë, me propozim të Këshillit drejtues të Agjencisë, miraton me akt nënligjor informacionin që mbahet dhe përpunohet në sistemin informatik për raportim dhe kompensim të Agjencisë, si dhe parimet, procedurat dhe rregullat për funksionimin e tij.
- Në rast të likuidimit të detyruar ose padisponueshmërisë së depozitave, me kërkesë të depozituesit, për të dhëna që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të, Agjencia i jep atij paraqitjen unike të depozituesit të raportuar në sistemin informatik për raportim dhe kompensim të Agjencisë, sipas aktit nënligjor të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

6. Ruajtja dhe përdorimi i informacionit të mbajtur nga Agjencia në sistemin informatik për raportim dhe kompensim bëhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, me legjislacionin për sigurinë kibernetike, me detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të përcaktuar në nenin 48 të këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 15

Detyrimi i anëtarëve të skemës për të informuar depozituesit

1. Institucionet e kreditit, SHKK-të, si dhe degët e këtyre subjekteve, u vënë në dispozicion depozituesve aktualë dhe atyre që synojnë të bëhen depozitues, informacionin e nevojshëm me qëllim identifikimin e skemës së sigurimit të depozitave, në të cilën këto subjekte janë anëtarë. Anëtarët e skemës duhet ta ofrojnë këtë informacion në formën e një flete informuese, të përgatitur në një format elektronik që mundëson identifikimin, lexueshmërinë dhe nxjerrjen automatike të të dhënave, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. Përmbajtja dhe formati i fletës informuese miratohet me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë të propozuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë.

2. Anëtarët e skemës përfshijnë në fletën informuese të gjitha informacionet si vijon:

- a) informacion bazë në lidhje me sigurimin e depozitave;
- b) të dhënat e kontaktit të anëtarit të skemës, si pikë e parë kontakti për informacionin lidhur me përmbajtjen e fletës informuese;
- c) nivelet e mbulimit për depozitat, sipas nenit 19, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji;
- ç) depozitat e përjashtuara, sipas nenit 18 të këtij ligji;
- d) sigurimi i depozitave të përbashkëta;
- dh) afati i kompensimit të depozitave në rast ngjarje sigurimi;
- e) monedha e pagesës së shumës së kompensimit;
- ë) identifikimi i skemës përgjegjëse për sigurimin e depozitave, duke përfshirë një referencë për faqen e saj të internetit.

3. Anëtarët e skemës u vendosin në dispozicion depozituesve aktualë dhe atyre që synojnë të bëhen depozitues fletën informuese, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përpara nënshkrimit të kontratës së depozitës dhe, më pas, sa herë që ka ndonjë ndryshim në informacionin e dhënë, por në çdo rast të paktën çdo pesë vjet. Anëtarët e skemës duhet të kërkojnë që depozituesit të konfirmojnë marrjen e fletës informuese, kur ata lidhin kontratën e depozitës.

4. Anëtarët e skemës konfirmojnë në pasqyrat e depozitave, që depozitat janë të pranueshme për sigurim, duke përfshirë një referencë për fletën informuese, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Faqja e internetit e Agjencisë duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për depozituesit, në veçanti informacionin në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave sipas depozitave të këtij ligji.

5. Anëtarët e skemës e bëjnë të disponueshëm, informacionin e përmendur në këtë nen, në gjuhën shqipe.

6. Anëtarët e skemës, gjatë fushatave promovuese të një produkti, e kufizojnë përdorimin e informacionit sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, vetëm për të evidentuar faktin që ky produkt sigurohet nga skema. Këto fushata promovuese mund të përfshijnë edhe një përshkrim faktik të funksioneve të skemës, por nuk lejohet të përmbajnë asnjë referencë për sigurimin e pakufizuar të depozitave.

7. Anëtarët e skemës, në rastin e bashkimit të tyre, të shndërrimit të filialeve në degë ose ndryshimeve të ngjashme, njoftojnë Agjencinë dhe depozituesit e tyre, të paktën një muaj para se këto ndryshime të hyjnë në fuqi, përveç rastit kur Banka e Shqipërisë lejon një afat më të shkurtër për arsye të sekretit tregtar ose të stabilitetit financiar. Ky njoftim duhet të përmbajë një shpjegim mbi ndikimin e këtyre ndryshimeve për depozituesit në lidhje me sigurimin e depozitave. Depozituesit, që preken nga këto ndryshime, mund të tërheqin ose të transferojnë, në një anëtar

tjetër të skemës, shumën e depozitave të tyre të pranueshme për sigurim që tejkalon nivelet e mbulimit të parashikuara në nenin 19, pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, përfshirë të gjitha interesat e përlllogaritura dhe përfitimet, pa asnjë penalitet, brenda tre muajve nga njoftimi i tyre nga anëtari i skemës.

8. Subjektet, që përfundojnë anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave, për shkak të anëtarësimit të tyre në një skemë tjetër të një shteti anëtar, duhet t'i njoftojnë depozituesit e tyre të paktën një muaj përpara këtij ndryshimi. Ky njoftim duhet të shpjegojë sesi ndikohen depozituesit nga ndryshimi i anëtarësisë të subjektit.

9. Në rast ngjarje sigurimi, Agjencia dhe anëtari i skemës informojnë depozituesit për këtë ngjarje, duke publikuar njoftimet përkatëse në faqet e tyre të internetit.

10. Nëse depozituesi përdor “*internet banking*”, anëtarët e skemës ua ofrojnë informacionin depozituesve të tyre, sipas këtij ligji, me anë të mjeteve elektronike, përveç nëse një depozitues kërkon ta marrë këtë informacion në letër.

11. Në rast se Agjencia konstaton nga ankesa e depozituesit dhe verifikimet, informacione të pasakta ose të rreme të dhëna për skemën, ajo merr masat e përcaktuara në nenin 68 të këtij ligji.

KREU IV

Sigurimi i depozitave

Neni 16

Kushtet e përgjithshme të sigurimit të depozitave

1. Depozitat sigurohen pavarësisht nëse janë në lekë apo në valutë të huaj.
2. Në rastin e depozitave të përbashkëta, pjesa përkatëse e secilit prej titullarëve me të drejta të plota merret parasysh në llogaritjen e depozitave të pranueshme për sigurim që ka depozituesi në anëtarin e skemës. Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e kontratës së depozitës, çdo depozitues me të drejta të plota prezumohet se zotëron pjesë të barabarta në depozitën në bashkëpronësi.
3. Në rastet e bashkimit ose ndarjes të një anëtarit të skemës, për efekt të llogaritjes së depozitave të siguruara, depozitat mbahen dhe sigurohen veçmas për çdo subjekt pjesëmarrës në këtë proces, për tre muaj prej datës kur Agjencia njoftohet me shkrim nga Banka e Shqipërisë për përfundimin e procesit të bashkimit ose ndarjes.
4. Në rastin e likuidimit vullnetar të një anëtarit të skemës, depozitat mbeten të siguruara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, deri në përfundimin e këtij procesi, sipas njoftimit të Bankës së Shqipërisë. Në çdo rast, Agjencia kompenson depozitat vetëm pasi të ketë marrë njoftim me shkrim nga Banka e Shqipërisë për padisponueshmërinë e depozitave ose vendosjen e anëtarit të skemës në likuidim të detyruar.
5. Në rastet kur një produkt i anëtarëve të skemës ka karakteristika të tilla që nuk e klasifikojnë automatikisht si depozitë të pranueshme për sigurim, Agjencia ka të drejtë të klasifikojë këtë produkt si depozitë të pranueshme për sigurim ose jo, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 17

Sigurimi i depozitave të fondeve të klientëve

1. Agjencia siguron depozitat e fondeve të klientëve, me kusht që të zbatohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme:
 - a) depozita është e vendosur në emër dhe për llogari të klientëve, të cilët nuk përjashtohen nga skema e sigurimit të depozitave, sipas nenit 18 të këtij ligji.

- b) depozita mbahet në llogari të ndara nga ato që institucionet financiare mbajnë për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës;
- c) klientët sipas shkronjës “a” të kësaj pike identifikohen ose janë të identifikueshëm nga institucioni financiar, i cili është mbajtësi i llogarisë, në emër dhe për llogari të këtyre klientëve, përpara datës së ngjarjes së sigurimit.
2. Niveli i mbulimit i përcaktuar në nenin 19, pika 1 të këtij ligji, zbatohet për secilin prej klientëve që plotësojnë kriterin e përcaktuar në pikën 1, shkronja “c” të këtij neni.
3. Shuma e kompensimit për depozitat e fondeve të klientëve nuk agregohet me shumën e kompensimit të depozituesit sipas nenit 25, pika 3 të këtij ligji, në rast ngjarje sigurimi.
4. Agjencia paguan kompensimin e depozitave të fondeve të klientëve ose te institucioni financiar i cili është mbajtësi i llogarisë, për përfitim të secilit klient, ose te vetë klienti drejtpërdrejt.
5. Kompensimi i depozitave për fondet e klientëve bëhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e miratuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

Neni 18

Depozitat e përjashtuara

Depozitat e përjashtuara nga sigurimi dhe kompensimi janë si vijon:

- a) depozitat e anëtarëve të skemës në emër dhe për llogari të tyre.
- b) fondet e veta të anëtarit të skemës.
- c) depozitat që rrjedhin nga veprimtari për të cilat është dhënë vendim gjyqësor i formës së prerë për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, ose të financimit të terrorizmit.
- ç) depozitat në emër dhe për llogari të institucioneve financiare, sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre.
- d) depozitat, titullari i të cilave nuk është identifikuar asnjëherë nga anëtari i skemës, në përputhje me vigjilencën e duhur sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, përveç rasteve kur titullari kërkon pagesën e shumës së kompensimit në rast ngjarje sigurimi, dhe as anëtari i skemës, as Agjencia, nuk mund të provojnë se mungesa e identifikimit është shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e titullarit të depozitës, si dhe me kusht që identiteti i tij të jetë verifikuar përpara kryerjes së pagesës së kompensimit;
- dh) depozitat e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit vendase ose të huaja.
- e) depozitat e subjekteve të investimeve kolektive vendase ose të huaja.
- ë) depozitat e fondeve të pensionit vendase ose të huaja.
- f) depozitat e institucioneve të administratës shtetërore, përveç depozitave të njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve, sipas legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
- g) tituj borxhi të emetuara nga subjektet financiare dhe çdo detyrim tjetër që këto subjekte kanë bazuar mbi marrëveshjet e tyre të premtimit.
- gj) Depozitat që plotësojnë kushtet për njohjen si instrumente që përmbushin kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar, sipas legjislacionit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, përfshirë rastin kur këto depozita kanë një maturim të mbetur më pak se një vit.

Neni 19

Nivelet e mbulimit

1. Niveli i mbulimit, në rast të një ngjarje sigurimi, është:
 - a) deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë për depozitat e agreguara të çdo depozituesi në një institucion kreditit anëtar të skemës.
 - b) deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë për depozitat e agreguara të çdo depozituesi në një SHKK anëtare të skemës.
2. Agjencia kompenson depozitat e individëve me balancë të përkohshme, mbi nivelin e mbulimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, deri në mbulimin prej 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, nëse fondet janë transferuar në llogari, ose nga momenti kur janë bërë ligjërisht të transferueshme, gjatë një periudhe jo më shumë se gjashtë muaj përpara datës së ngjarjes së sigurimit.
3. Depozitat me balancë të përkohshme, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, janë depozitat, të cilat burojnë nga:
 - a) transaksionet për pasuri të paluajtshme për banim, me kusht që depozituesi individ të paraqesë dokumentacionin që vërteton këto transaksione.
 - b) përfitimet sociale të përcaktuara në legjislacionin në lidhje me ngjarje të tilla si martesë, divorci, pensioni, pushimi nga puna, largimi nga puna, lindja, paaftësia, trashëgimia ose vdekja, me kusht që depozituesi individ të paraqesë dokumentacionin që vërteton këto ngjarje dhe të drejtën e përfitimit të miratuar nga institucioni përkatës.
 - c) përfitimet e sigurimit dhe risigurimit, me kusht që depozituesi individ të dorëzojë dokumentacionin nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit që vërtetojnë këto përfitime.
 - ç) dëmshpërblimi i marrë për shkak të dënimeve të padrejta penale, me kusht që depozituesi individ të paraqesë vendimin përkatës gjyqësor.
4. Niveli i mbulimit për depozitat me balancë të përkohshme do të zbatohet për shumën e agreguar të kategorive nga shkronja “a” deri në shkronjën “ç” të pikës 3 të këtij neni.
5. Shuma totale e kompensimit për depozitat me balancë të përkohshme, me më shumë se një përfitues, nuk mund të jetë më e lartë se niveli i mbulimit i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
6. Shuma e kompensimit për depozitat me balancë të përkohshme sipas pikës 2 të këtij neni nuk agregohet me shumën e kompensimit të depozituesit sipas pikës 1 të këtij neni, në rast ngjarje sigurimi.
7. Shuma e kompensimit për depozitat me balancë të përkohshme sipas pikës 2 të këtij neni përfitohet vetëm nëse depozituesi individ paraqet në Agjenci kërkesën të shoqëruar me dokumentat justifikues, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e ngjarjes së sigurimit. Kërkesat e depozituesve individë, sipas kësaj pike do të konfirmohen nga likuidatori i anëtarit të skemës të vendosur në likuidim të detyruar ose vetë anëtar i skemës, depozitat e të cilit janë të padisponueshme. Kompensimi i këtyre depozitave bëhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e miratuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.
8. Agjencia vlerëson të paktën një herë në çdo pesë vjet përputhshmërinë e niveleve të mbulimit, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, me objektivin publik të skemës së sigurimit të depozitave sipas këtij ligji.

Neni 20

Kontributi fillestar

1. Çdo subjekt, që kërkon anëtarësimin në skemë, paguan një kontribut fillestar në masën 0,5 për qind të kapitalit fillestar, të konvertuar në lekë, në llogarinë e Agjencisë pranë Bankës së

Shqipërisë, përpara marrjes së certifikatës së anëtarësimit në skemë.

2. Çdo subjekt që anëtarësohet në skemë paguan në fund të vitit të parë të anëtarësimit, shtesën e kontributit fillestar që llogaritet në masën 0,5 për qind të kapitalit të shtuar gjatë atij viti.

3. Këshilli Drejtues i Agjencisë mund të vendosë përjashtimin nga detyrimi për të paguar kontributin fillestar për anëtarët e rinj të skemës, të cilët krijohen duke marrë përsipër depozitat dhe detyrimet e një subjekti anëtar ekzistues.

Neni 21

Kontributi vjetor i primit për institucionet e kreditit anëtare të skemës

1. Institucionet e kreditit anëtare të skemës paguajnë kontributet vjetore të primit të bazuar në rrezik, të llogaritura në përpjesëtim me shumën e depozitave të siguruara të mbajtura në çdo institucion të kreditit anëtar, dhe me shkallën e rrezikut të marrë përsipër nga secili institucion i kreditit anëtar i skemës.

2. Detyrimi i institucioneve të kreditit anëtare për të paguar kontributin vjetor të primit shpërndahet në kohë, në mënyrë sa më të barabartë që të jetë e mundur, deri në arritjen dhe ruajtjen e nivelit të synuar të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit, të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, por duke marrë parasysh fazën e ciklit të biznesit dhe ndikimin prociklik që kontributet vjetore të primit mund të kenë ndaj institucioneve të kreditit anëtare të skemës.

3. Llogaritja e kontributeve vjetore të primit bazohet në mesataren e shumës së depozitave të siguruara të çdo institucioni të kreditit anëtar të skemës, në ditën e fundit të çdo tremujori për vitin paraardhës. Depozita e siguruar për çdo depozitues llogaritet duke agreguar depozitat e pranueshme për sigurim, përfshirë edhe interesin e llogaritur deri në datën e raportimit, pavarësisht nga numri i depozitave apo monedha e tyre, deri në nivelin e mbulimit sipas nenit 19, pika 1, shkronja “a” të këtij ligji.

4. Për depozitat e siguruara në valutë të huaj, konvertimi në lekë bëhet në bazë të kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për ditën e raportimit.

5. Për qëllim të llogaritjes së kontributit vjetor të primit, institucionet e kreditit anëtare të skemës raportojnë në sistemin informatik për raportim dhe kompensim të dhënat për depozitat e siguruara, sipas formatit standard të të dhënave të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

6. Agjencia merr nga Banka e Shqipërisë brenda datës 30 prill të çdo viti, të dhënat për treguesit e profilit të rrezikut të çdo institucioni të kreditit anëtar të skemës, në përputhje me metodologjinë, të miratuar sipas pikës 9 të këtij neni.

7. Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton shumën përkatëse të kontributit vjetor të primit që duhet të paguajnë institucionet e kreditit anëtare të skemës. Agjencia brenda datës 30 qershor të çdo viti, do të informojë me shkrim secilin institucion të kreditit anëtar të skemës mbi shumën e kontributit vjetor të primit që duhet të paguhet, për periudhën 1 korrik deri 30 qershor të vitit pasues. Kontributi vjetor i primit nga institucionet e kreditit anëtare të skemës do të paguhet në katër këste. Kësti i parë paguhet jo më vonë se data 31 korrik, ndërsa këstet e tjera jo më vonë se data 15 e muajit të parë të secilit tremujor pasues brenda periudhës për të cilën paguhet kontributi vjetor i primit.

8. Pagesa e kontributit vjetor të primit bëhet në lekë në llogarinë e Agjencisë, në Bankën e Shqipërisë.

9. Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë, Banka e Shqipërisë miraton metodologjinë për llogaritjen e kontributeve vjetore të primeve të bazuara në rrezik për institucionet e kreditit anëtare të skemës. Agjencia vlerëson të paktën një herë në pesë vjet, nëse kjo metodologji ka nevojë për rishikim.

10. Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe me miratimin e Bankës së Shqipërisë, institucionet e kreditit anëtare të skemës paguajnë para afatit kontributin vjetor të primit. Shuma e kontributit vjetor të primit të paguar para afatit nuk duhet të jetë më e madhe se shumta e kontributit vjetor të primit të paguar për periudhën paraardhëse, në përputhje me nenin 56, pika 1, shkronja “a” të këtij ligji.

11. Nëse shumta e kontributit vjetor të primit të paguar para afatit ndryshon nga ajo e llogaritur sikur kontributi vjetor i primit të paguhej në afat, atëherë diferenca korrigjohet përkatësisht për periudhën pasardhëse për secilin institucion të kreditit.

12. Kontributi vjetor i primit për institucionet e kreditit anëtare të skemës, në rast të marrjes së huasë në përputhje me nenin 56 të këtij ligji, përllogaritet në mënyrë që të mundësojë shlyerjen e huasë, si dhe për të arritur nivelin e synuar të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit.

Neni 22

Kontributi tremujor i primit për SHKK-të anëtare të skemës

1. SHKK-të anëtare të skemës paguajnë kontributet tremujore të primit të llogaritura mbi bazën e depozitave të siguruara.

2. Kontributi tremujor i primit është 0,125 për qind e mesatares të shumës së depozitave të siguruara, që janë të regjistruara në SHKK në ditën e fundit të çdo muaji të tremujorit të mëparshëm. Depozita e siguruar për çdo depozitues llogaritet duke agreguar depozitat e pranueshme për sigurim, përfshirë edhe interesin e llogaritur deri në datën e raportimit, pavarësisht nga numri i depozitave apo monedha e tyre, deri në nivelin e mbulimit sipas nenit 19, pika 1, shkronja “b” të këtij ligji.

3. Për efekt të llogaritjes së kontributit tremujor të primit, tremujori fillon ditën e parë të muajve janar, prill, korrik dhe tetor.

4. Kontributi tremujor i primit paguhet nga SHKK-të anëtare të skemës jo më vonë se data 15 e muajit të parë të tremujorit për të cilin paguhet. Pagesa e kontributit tremujor të primit bëhet në lekë në llogarinë e Agjencisë, në Bankën e Shqipërisë.

5. Njëkohësisht me pagesën e kontributit tremujor të primit, SHKK-të i paraqesin Agjencisë deklaratën e llogaritjes kontributit tremujor të primit, sipas kërkesave të Agjencisë.

6. Për qëllim të llogaritjes së kontributit tremujor të primit, SHKK-të anëtare të skemës raportojnë në sistemin informatik për raportim dhe kompensim të dhënat për depozitat e siguruara, sipas formatit standard të të dhënave të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

7. Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe me miratimin e Bankës së Shqipërisë, SHKK-të anëtare të skemës paguajnë para afatit kontributin tremujor të primit në përputhje me nenin 56, pika 1, shkronja “a” të këtij ligji. Kontributi tremujor i primit të paguar para afatit duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se katërfishi i kontributit tremujor të primit të paguar për periudhën paraardhëse.

8. Nëse kontributi tremujor i primit të paguar para afatit ndryshon nga llogaritja e kontributit tremujor të primit për periudhën pasardhëse, atëherë diferenca korrigjohet përkatësisht, në fund të periudhës për të cilën është paguar primi para afatit.

Neni 23

Kontributi i jashtëzakonshëm

1. Nëse mjetet financiare të disponueshme të Agjencisë nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e Agjencisë ndaj depozituesve në rast ngjarje sigurimi, me propozimin e Këshillit

Drejtues të Agjencisë dhe miratimin e Bankës së Shqipërisë, anëtarët e skemës paguajnë një kontribut të jashtëzakonshëm, shuma e të cilit për një vit kalendarik nuk kalon 0,5 për qind të depozitave të siguruara të këtij anëtar, të regjistruara më 31 dhjetor të vitit paraardhës.

2. Në raste të jashtëzakonshme, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe me miratim të Bankës së Shqipërisë, anëtarët paguajnë kontribute të jashtëzakonshme më të larta se masa e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Me kërkesë të një anëtar, Banka e Shqipërisë mund të shtyjë, tërësisht ose pjesërisht, pagesën e kontributit të jashtëzakonshëm, për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj, në rast se kjo pagesë do të rrezikonte likuiditetin ose aftësinë paguese të anëtarit përkatës.

4. Me kërkesë të anëtarit, Banka e Shqipërisë mund të rinovojë periudhën e shtyrjes nëse rrethanat e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni vazhdojnë të ekzistojnë.

5. Anëtar i paguan kontributin e jashtëzakonshëm, sipas vendimit të Bankës së Shqipërisë, nëse nuk ekziston më rreziku për likuiditetin dhe aftësinë paguese të tij.

6. Banka e Shqipërisë njofton menjëherë Agjencinë dhe ministrinë përgjegjëse për financat për vendimin e marrë sipas pikave 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

7. Kontributi i jashtëzakonshëm paguhet në lekë, në llogarinë e Agjencisë, në Bankën e Shqipërisë, sipas afatit të përcaktuar në vendimin e Bankës së Shqipërisë.

Neni 24

Kontabilizimi i kontributeve fillestare, kontributeve vjetore ose tremujore të primit dhe kontributeve të jashtëzakonshme

1. Kontributet fillestare, kontributet vjetore ose tremujore të primit dhe kontributet e jashtëzakonshme llogariten si shpenzime të anëtarit.

2. Kontributet fillestare, kontributet vjetore ose tremujore të primit dhe kontributet e jashtëzakonshme janë të pakthyeshme.

KREU V Kompensimi

Neni 25

Llogaritja e shumës së kompensimit

1. Shuma e kompensimit është vlera monetare që i njihet ose i paguhet depozituesit në rast ngjarje sigurimi në një anëtar të skemës, në përputhje me këtë ligj.

2. Llogaritja e shumës së kompensimit bëhet në datën e ngjarjes së sigurimit në një anëtar të skemës. Depozitat në valutë konvertohen në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit, të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në datën e ngjarjes së sigurimit.

3. Shuma e kompensimit për depozitues llogaritet duke agreguar depozitat e pranueshme për sigurim, përfshirë depozitat e vendosura në datën e ngjarjes së sigurimit, si dhe interesin e llogaritur deri në datën e ngjarjes së sigurimit, pavarësisht nga numri i depozitave apo monedha e tyre, deri në nivelin e mbulimit sipas nenit 19, pika 1 dhe 2 të këtij ligji.

4. Pjesa përkatëse e çdo depozituesi në një depozitë të përbashkët përfshihet në llogaritjen e shumës së kompensimit, për çdo depozitues deri në nivelin e mbulimit sipas nenit 19, pika 1 e këtij ligji. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në kushtet e kontratës së depozitës, çdo depozitues prezumohet se zotëron pjesë të barabarta në depozitat në bashkëpronësi.

5. Nëse një depozitues nuk ka të drejta të plota mbi një depozitë, shuma e kompensimit do t'i paguhet përfituesit të kësaj depozite, me kusht që ky përfitues të identifikohet ose të jetë i

identifikueshëm përpara datës së ngjarjes së sigurimit, si dhe të mos jetë i përjashtuar nga skema e sigurimit të depozitave, sipas nenit 18 të këtij ligji. Në rast se depozita ka disa përfitues, ajo do të trajtohet si depozitë e përbashkët. Në rastin e depozitës të mbajtur nga një mbajtës llogarie, në një llogari të veçantë për qëllime profesionale, në emër të një depozituesi me të drejta të plota, kjo depozitë nuk do të agregohet me depozitat e tjera që depozituesi me të drejta të plota ka në të njëjtin anëtar të skemës, për qëllim të përcaktimit të shumës së kompensimit, nëse ky depozitues me të drejta të plota identifikohet nga mbajtësi i llogarisë. Këto depozita nuk i nënshtrohen pretendimeve të të tretëve kundrejt mbajtësit të llogarisë. Agjencia paguan shumën e kompensimit mbajtësit të llogarisë, për përfitim të depozituesit me të drejta të plota, ose drejtpërdrejt depozituesit me të drejta të plota.

6. Shuma e kompensimit për depozitat e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni, përfitohet vetëm nëse kërkesa paraqitet në Agjenci e shoqëruar me dokumentat justifikues, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e ngjarjes së sigurimit. Kërkesat e depozituesve, sipas kësaj pike do të konfirmohen nga likuidatori i anëtarit të skemës të vendosur në likuidim të detyruar ose vetë anëtari i skemës, depozitat e të cilit janë të padisponueshme. Kompensimi i këtyre depozitave bëhet në përputhje me kriteret dhe procedurat e miratuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

7. Një depozitë e barrësuar, e sekuestruar ose që shërben si kolateral financiar do të agregohet për llogaritjen e shumës së kompensimit. Shuma e kompensimit nuk do t'i paguhet depozituesit, derisa të hiqet barra, sekuestroja ose kolaterali financiar. Në rastet kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë për këtë depozitë, Agjencia do t'i paguajë shumën e kompensimit personit të përcaktuar në vendimin e gjykatës si përfitues i kësaj shume.

8. Shpenzimet administrative të Agjencisë lidhur me procedurën e pagesës së kompensimit nuk i ngarkohen depozituesit në shumën e kompensimit.

9. Agjencia ka të drejtë të refuzojë ose të kërkojë kthimin e shumës së kompensimit, kur llogaritja e shumës së kompensimit bazohet në të dhëna të rreme dhe mashtruese.

Neni 26

Afatet e pagesës së shumës së kompensimit

1. Agjencia kompenson depozitat e siguruara depozituesve të anëtarëve të skemës, deri në nivelin e mbulimit, në rast të:

- a) Vendimit të Bankës së Shqipërisë për likuidimin e detyruar, ose
- b) Vendimit të Bankës së Shqipërisë për padisponueshmërinë e depozitave.

2. Agjencia duhet të mundësojë që shuma e kompensimit të jetë e disponueshme për depozituesit sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda katërmëdhjetë ditëve pune, nga data e vendimeve të Bankës së Shqipërisë, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Afati i pagesës së shumës së kompensimit për depozitat e përcaktuara në nenin 19, pika 2 është deri në 30 ditë pune nga data që depozituesi paraqet në Agjenci kërkesën dhe dokumentacionin e plotë që vërteton të drejtën e përfitimit të shumës së kompensimit.

4. Afati i kryerjes së pagesës të shumës së kompensimit, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni zgjatet në rastet e mëposhtme:

a) është e paqartë se cili është përfituesi i shumës së kompensimit, ose depozita është objekt i çështjeve gjyqësore. Shuma e kompensimit duhet të paguhet brenda 14 ditëve pune nga data që Agjencia njoftohet nga likuidatori mbi përcaktimin e përfituesit të shumës së kompensimit ose mbi vendimin gjyqësor të formës së prerë.

b) nuk ka pasur asnjë transaksion lidhur me depozitën në 24 muajt e fundit, (llogaria është në gjendje të fjetur), përveç rastit kur depozituesi ka depozita të tjera aktive në anëtarin e skemës. Në këto raste, shuma e kompensimit duhet të paguhet brenda 14 ditëve pune nga data që Agjencia

njoftohet nga likuidatori për shumën e kësaj depozite.

5. Agjencia nuk është e detyruar të ndërmarrë masa për pagesën e shumës së kompensimit në rastin kur depozita në mënyrë kumulative plotëson këto kushte:

a) nuk ka pasur asnjë transaksion lidhur me depozitën në 24 muajt e fundit, (llogaria është në gjendje të fjetur), si dhe

b) shuma e depozitës është më e ulët se kosto administrative e Agjencisë për të paguar këtë shumë, e cila përcaktohet me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, të propozuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë.

Pavarësisht sa më sipër, Agjencia do të kompensojë këtë depozitë, nëse depozituesi e kërkon pagesën e kompensimit të saj.

6. Agjencia pezullon pagesën e shumës së kompensimit, në rast se depozita është subjekt i masave të bllokimit të vendosura sipas legjislacionit për masat kundër financimit të terrorizmit, ose masave shtrënguese ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë. Agjencia pezullon pagesën e shumës së kompensimit edhe kur depozita është objekt i urdhërit për pezullimin e kryerjes së transaksionit ose për bllokimin e llogarisë, të nxjerrë sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, për gjithë kohëzgjatjen e masës. Koha e pezullimit nuk llogaritet në afatet e kompensimit të parashikuara në këtë nen.

7. Likuidatori, evidenton depozitat e përcaktuara sipas pikës 6 të këtij neni, me qëllim identifikimin e menjëhershëm të tyre, si dhe njofton menjëherë Agjencinë lidhur me këto depozita, në bazë të vendimit të çdo institucioni që ka kompetencën me ligj për sanksionimin e tyre.

8. Agjencia nuk është përgjegjëse për tejkalimin e afatit të kompensimit, të përcaktuar në këtë ligj, për shkak të forcës madhore.

Neni 27

Procedura e pagesës së shumës së kompensimit

1. Shuma e kompensimit paguhet pa qenë e nevojshme që depozituesi të paraqesë ndonjë kërkesë për përfitimin e saj, përveç rastit të depozitave të përcaktuara, në nenin 19, pika 7 dhe në nenin 25, pika 5 të këtij ligji.

2. Barra e provës për të vërtetuar të drejtën e përfitimit të shumës së kompensimit për depozitat e përcaktuara në nenin 19, pika 7 dhe në nenin 25, pika 5 të këtij ligji i takon depozituesit.

3. Kompensimi i depozituesve mund të kryhet nëpërmjet institucioneve të kreditit anëtare të skemës, subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të pagesave ose drejtpërdrejtë nga Agjencia nëpërmjet pagesës në llogarinë e depozituesit.

4. Këshilli Drejtues i Agjencisë përzgjedh në një listë paraprake institucionet e kreditit anëtare të skemës, si dhe kur e gjykon të nevojshme, subjekte të tjera të licensuara nga Banka e Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të pagesave, të cilat përmbushin kriteret për kryerjen e pagesave të shumave të kompensimit.

5. Brenda tre ditëve pune nga data e ngjarjes së sigurimit, Këshilli Drejtues i Agjencisë vendos për mënyrën e kompensimit sipas pikës 3 të këtij neni dhe në varësi të mënyrës së kompensimit të miratuar përzgjedh nga lista paraprake institucionin/et e kreditit agjente, ose subjektin/et e tjera të licensuara nga Banka e Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të pagesave që do të kryejnë pagesat e shumës së kompensimit. Kriteret e përzgjedhjes së institucioneve të kreditit agjente, si dhe të subjekteve të tjera të licensuara nga Banka e Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të pagesave përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

6. Pagesat e shumës së kompensimit kryhen sipas mjeteve të pagesës të miratuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

7. Jo më vonë se katër ditë pune nga data e ngjarjes së sigurimit, Agjencia publikon njoftimin për datën e fillimit të procesit të pagesave të kompensimit, institucioni/et e kreditit agjente, ose subjektet e tjera që do të kryejnë pagesat, si dhe mjetet e pagesave.
8. Marrëdhëniet e institucionit të kreditit agjent dhe likuidatorit me Agjencinë përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.
9. Agjencia ka të drejtë të kërkojë nga depozituesit, për të përfituar shumën e kompensimit, dokumentacionin përkatës të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.
10. Depozituesit kanë të drejtën e përfitimit të shumës së kompensimit brenda 5 vjetëve nga data e ngjarjes së sigurimit, sipas njoftimit të Bankës së Shqipërisë.
11. Nëse procedurat e likuidimit të detyruar të institucionit të kreditit ose SHKK-së zgjasin më shumë se 5 vjet, e drejta e depozituesve për të përfituar shumën e kompensimit zgjatet deri në datën e përfundimit të likuidimit të detyruar, sipas njoftimit të Bankës së Shqipërisë.
12. Fondet e kompensimit që mbeten të papaguara, mbahen nga Agjencia në një llogari të veçantë në Bankën e Shqipërisë, deri në përfundimin e afatit sipas pikave 10 dhe 11 të këtij neni. Pas këtij afati këto fonde përfshihen në fondin e sigurimit të depozitave përkatës.
13. Agjencia nuk paguan interesa në shumën e kompensimit, pas datës së ngjarjes së sigurimit.
14. Agjencia kompenson depozituesit për shumat e kompensimit që tejkalojnë vlerën ekuivalente në lek e shumës deri në 10.000 (dhjetë mijë) euro, vetëm nëpërmjet transfertave të kreditit, ose, kur transferta të tilla krediti nuk janë të mundshme, nëpërmjet mjeteve të pagesës, që sigurojnë gjurmueshmërinë e fondeve.

Neni 28

Listëpagesa me paraqitjen unike të depozituesit

1. Likuidatori jo më vonë se 2 ditë pune nga data e vendosjes në likuidim të detyruar të anëtarit të skemës, ose subjekti anëtar i skemës jo më vonë se 2 ditë pune nga data e vendimit të padisponueshmërisë së depozitave, i jep Agjencisë listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesit, sipas formatit standard të të dhënave të miratuar nga Këshilli Drejtues.
2. Listëpagesa me paraqitjen unike të depozituesve përmban vlerën neto të depozitave që janë të kompensueshme deri në nivelet e mbulimit, pasi është zbritur tatimi mbi interesat e pagueshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Agjencia verifikon listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesit të dërguar nga likuidatori ose anëtar depozitat e të cilit janë të padisponueshme dhe krijon listëpagesën përfundimtare, e cila i dërgohet institucionit të kreditit agjent.
4. Likuidatori ose subjekti anëtar i skemës, depozitat e të cilit janë të padisponueshme, i dërgon Agjencisë listëpagesën e përditësuar të paraqitjes unike të depozituesit për çdo ndryshim.
5. Likuidatori ose anëtar i skemës, depozitat e të cilit janë të padisponueshme, është përgjegjës për vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit të paraqitur në Agjenci. Agjencia nuk mban përgjegjësi për kompensimin e depozitave depozituesve të gabuar, as për kompensimin e depozitave në masën e gabuar, bazuar në listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesve. Përveç kësaj, Agjencia nuk është përgjegjëse për moskompensimin e depozituesit, i cili nuk është përfshirë në listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesit, të paraqitur nga likuidatori ose anëtar i skemës, depozitat e të cilit janë të padisponueshme.
6. Agjencia ka të drejtë të ankimojë veprimet e likuidatorit ose anëtarit të skemës, depozitat e të cilit janë të padisponueshme, në Bankën e Shqipërisë, kur vëren se ato janë në kundërshtim me interesat e saj ligjore, në përputhje me legjislacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre dhe në legjislacionin për SHKK-të në Republikën e Shqipërisë.

Neni 29

Padisponueshmëria e depozitave

1. Agjencia me marrjen e vendimit të Bankës së Shqipërisë për padisponueshmërinë e depozitave në një anëtar të skemës kompenson depozitat e siguruara në përputhje me nenet 25, 26, 27 dhe 28 të këtij ligji.
2. Agjencia trajton ankesat e depozituesve në rast të padisponueshmërisë së depozitave në përputhje me nenin 31 të këtij ligji.

Neni 30

Pjesëmarrja e Agjencisë me transferim të mjeteve financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave gjatë procedurave të likuidimit të detyruar të një anëtarit të skemës

1. Gjatë procedurave të likuidimit të detyruar të një anëtarit të skemës, me qëllim që depozituesi të ketë mundësinë e përdorimit të pandërprerë të depozitave, mjetet financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit ose të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, mund të përdoren për të financuar transferimin e aktiveve dhe detyrimeve, përfshirë edhe transferimin e portofolit të depozitave të institucionit të kreditit ose SHKK-së, që vendoset në likuidim të detyruar te një institucion krediti ose SHKK blerëse.
2. Banka e Shqipërisë i kërkon Agjencisë jo më vonë se dy ditë pune nga data e vendosjes të anëtarit në likuidim të detyruar, shumë e nevojshme për financimin e transferimit sipas vlerësimit në përputhje me legjislacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre dhe legjislacionin për shoqëritë e kursim – kreditit dhe unionet e tyre.
3. Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton shumë për financimin e transferimit të mjeteve financiare të disponueshme nga fondi përkatës i sigurimit të depozitave. Në çdo rast, shuma e transferuar nga fondi përkatës i sigurimit të depozitave, nuk duhet të tejkalojë më të voglën nga shumatat e mëposhtme:
 - a) shumë e depozitave të siguruara në anëtarin e skemës; ose
 - b) shumë që rezulton nga përmbushja e kushteve për të financuar diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve të transferuara, sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Kur fondi i sigurimit të depozitave është përdorur në përputhje me këtë nen, depozituesit nuk gëzojnë të drejtën të ngrenë asnjë pretendim ndaj Agjencisë në lidhje me çdo pjesë të depozitave të tyre të transferuara.

Neni 31

Ankesat gjatë procedurës së kompensimit

1. Personi ose subjekti që pretendon se është depozitues dhe që i është refuzuar pagesa e shumës së kompensimit, ose që nuk është dakord me shumë e kompensimit, ose kur ka mospërputhje ndërmjet të dhënave të listëpagesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga depozituesi, sipas përcaktimeve të këtij ligji, mund të paraqesë një ankesë që nga data e fillimit të procesit të kryerjes së pagesave, deri në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 27, pika 10 dhe 11 të këtij ligji.
2. Ankesat e depozituesve në një proces kompensimi shqyrtohen nga Agjencia, brenda 30 ditëve kalendrike nga marrja e ankesës të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Likuidatori ose anëtar i skemës, depozitat e të cilit janë të padisponueshme, i paraqet Agjencisë të dhënat dhe dokumentacionin për shqyrtimin e ankesave të depozituesve. Afati i shqyrtimit të

ankesave ndërpritet dhe rifillon pasi likuidatori, ose anëtar i skemës, depozitat e të cilit janë të padisponueshme, ka paraqitur të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga Agjencia. Agjencia bën ndryshime në listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesve, sipas vendimit përfundimtar të saj.

4. Vendimi i Agjencisë ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe zbatohet pa kufizim deri në marrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

5. Ankesat shqyrtohen sipas kriterëve dhe procedurave të miratuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë.

Neni 32

Cedimi i të drejtave dhe tagrave të depozituesve në rast ngjarje sigurimi

1. Nga data e fillimit të pagesave të shumës së kompensimit, sipas nenit 26, pika 2 të këtij ligji, Agjencisë i cedohen të drejtat dhe tagrat e depozituesve ndaj anëtarit të skemës, i cili është në likuidim të detyruar ose depozitat e të cilit janë të padisponueshme, deri në totalin e depozitave të siguruara, pavarësisht nga shuma dhe data në të cilën depozituesit kanë përfituar shumat e kompensimit.

2. Në rast të pjesëmarrjes së Agjencisë me transferim të mjeteve financiare të disponueshme nga fondet e sigurimit të depozitave, gjatë procedurave të likuidimit të detyruar të anëtarit të skemës, Agjencia pretendon të rrimarrë shumën e transferuar vetëm kundrejt asaj pjese të anëtarit që kalon në likuidim të detyruar.

3. Në rastet kur Agjencia merr pjesë në ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit me transferim të mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit, Agjencia pretendon të rrimarrë shumën e transferuar, vetëm kundrejt asaj pjese të institucionit të kreditit, që kalon në likuidim të detyruar, dhe jo për pjesën e institucionit të kreditit, ndaj së cilës janë zbatuar instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

4. Pretendimet e Agjencisë sipas pikës 1, 2 dhe 3 të këtij neni, renditen sipas radhës të shlyerjes të përcaktuara në legjislacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre, në legjislacionin për SHKK-të në Republikën e Shqipërisë, si dhe në legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit, në Republikën e Shqipërisë.

5. Agjencia ka të drejtën e veprimit ose të mosveprimit në përdorimin e të drejtave dhe tagrave të depozituesve që i cedohen, deri në nivelet e mbulimit.

6. Cedimi i të drejtave dhe tagrave të depozituesve që kompensohen nga Agjencia nuk çënon të drejtat dhe tagrat e këtyre depozituesve ndaj anëtarit të skemës, për shumën që tejkalon nivelet e mbulimit në përputhje me nenin 19 të këtij ligji ose për depozitat e përjashtuara në përputhje me nenin 18 të këtij ligji.

KREU VI

Agjencia e Sigurimit të Depozitave

Neni 33

Forma ligjore e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

1. Agjencia është person juridik publik, me seli në Tiranë.

2. Agjencia administron skemën e sigurimit të depozitave të institucioneve të kreditit dhe të SHKK-ve.

3. Agjencia ka në pronësi mjetet financiare të krijuara nga burimet e përcaktuara në këtë ligj.

4. Agjencia ka logon dhe vulën e saj të mbrojtur nga kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë.
5. Agjencia shpërndalet dhe likuidohet me ligj.

Neni 34

Pavarësia institucionale e Agjencisë

1. Agjencia gëzon pavarësi operationale dhe financiare nga çdo subjekt tjetër, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.
2. Agjencia mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë.

Neni 35

Raportimi i Agjencisë

1. Agjencia raporton në Kuvend, në ministrinë përgjegjëse për financat dhe në Bankën e Shqipërisë për veprimtarinë e saj vjetore.
2. Raporti vjetor dhe dokumentet financiare të audituara të Agjencisë i paraqiten Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ministrisë përgjegjëse për financat dhe Bankës së Shqipërisë jo më vonë se katër muaj nga mbyllja e vitit financiar.
3. Agjencia publikon raportin vjetor dhe dokumentet financiare të audituara në faqen e saj të internetit.

Neni 36

Funksionet e Agjencisë

1. Agjencia ushtron funksionet e saj me qëllim të arritjes së objektivit publik të skemës në përputhje me këtë ligj. Në veçanti, Agjencia:
 - a) siguron dhe kompenson depozitat në institucionet e kreditit dhe SHKK, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
 - b) merr pjesë me transferim mjetesh financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave gjatë procedurave të likuidimit të detyruar të anëtarit të skemës, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, me legjislacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre, si dhe me legjislacionin për SHKK-të në Republikën e Shqipërisë.
 - c) merr pjesë me transferim mjetesh financiare të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit në përputhje me legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit në Republikën e Shqipërisë.
 - ç) anëtarëson dhe përjashton anëtarët nga skema, si dhe mban regjistrin e anëtarëve të skemës.
 - d) kryen verifikime të plota dhe të pjesshme për sigurimin dhe kompensimin e depozitave tek anëtarët, në veçanti për cilësinë e raportimit të paraqitjes unike të depozituesit dhe cilësinë e të dhënave të raportuara periodikisht nga anëtarët të skemës, nëpërmjet aksesit në të dhënat e anëtarëve për depozituesit dhe depozitat, si dhe verifikon informimin e depozituesve nga anëtarët e skemës.
 - dh) përpunon në mënyrë elektronike të dhënat e raportuara nga anëtarët e skemës.
 - e) arkëton kontribute fillestare, kontributet vjetore ose tremujore të primit dhe kontributet e jashtëzakonshme;
 - ë) administron fondin e sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe fondin e sigurimit të depozitave në SHKK, si dhe investon mjetet financiare të disponueshme të tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
 - f) administron fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në përputhje me legjislacionin për

rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

g) administron fondin e kompensimit të investitorëve në përputhje me legjislacionin për tregjet e kapitalit në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

gj) kryen simulime të procesit të kompensimit të depozitave, duke përfshirë anëtarët dhe subjektet e kontraktuara, me qëllim identifikimin e gatishmërisë së tyre për këtë proces.

h) merr pjesë në planet e kontingjencës për parandalimin dhe administrimin e rreziqeve sistematike, në kuadër të rrjetit të sigurisë financiare.

i) vendos masat parandaluese ndaj anëtarëve në rastet e mosrespektimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij, në përputhje me nenin 68 të këtij ligji.

j) i propozon Bankës së Shqipërisë vendosjen e gjobave ose masave administrative ndaj anëtarëve.

k) përfiton mjetet financiare shtesë nëpërmjet marrjes së huave, garancive, subvencioneve dhe granteve, në rast ngjarje sigurimi.

l) kryen analizë financiare e parashikuese dhe vlerëson nivelin e ekspozimit të skemës në rast ngjarje sigurimi të mundshme.

ll) jep konsulencë teknike lidhur me veprimtarinë e saj.

m) krijon dhe mirëmban faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe zhvillon veprimtari promociionale me qëllim ndërgjegjësimin e publikut mbi skemën.

n) kryen çdo funksion tjetër që rrjedh drejtpërdrejt nga funksionet e mësipërme.

Neni 37

Të drejtat e Agjencisë

1. Për të përmbushur objektivat dhe funksionet e saj, Agjencia ka këto të drejta:

a) miraton buxhetin e saj;

b) miraton strukturën e saj organizative;

c) nxjerr akte në përputhje me nenin 3, pika 2 të këtij ligji;

ç) lidh kontrata dhe marrëveshje me subjekte publike dhe private;

d) zotëron, gëzon, disponon, blen pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që i shërbejnë veprimtarisë së saj;

dh) miraton nivelin dhe strukturën e pagave dhe shpërblimeve, trajtimet e tjera financiare dhe përfitimet për punonjësit e Agjencisë, si dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues;

e) merr shërbime konsulente të lidhura me veprimtarinë e sigurimit dhe kompensimit të depozitave.

2. Agjencia është subjekt i përgjashtimeve tatimore të parashikuara në legjislacionin tatimor në fuqi për veprimtarinë e saj të sigurimit të depozitave, kompensimit dhe administrimit të mjeteve financiare.

3. Agjencia nuk përgjigjet për detyrimet dhe përgjegjësitë e Republikës së Shqipërisë.

4. Fondet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nuk mund të bllokohen, të sekuestrohen apo t'i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm.

5. Agjencia mund të kontraktojë palë të treta për kryerjen e çdo veprimtarie me qëllim përmbushjen e funksioneve të saj në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

6. Vetëm për qëllime të përgatitjes dhe kryerjes së funksioneve të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi, Agjencia përjashtohet si subjekt i depozitave të ligjit për prokurimin publik dhe të akteve nënligjore në fuqi për zbatimin e tij. Banka e Shqipërisë miraton me akt nënligjor rregullat dhe procedurat për kontraktim për përgatitjen dhe kryerjen e funksioneve të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi.

Neni 38
Organizimi i Agjencisë

Agjencia organizohet, drejtohet dhe kryen veprimtarinë e saj nëpërmjet Këshillit Drejtues, Drejtorit të Përgjithshëm dhe punonjësve, siç përcaktohet në këtë ligj.

Neni 39
Kriteret për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues dhe të Drejtorit të Përgjithshëm

1. Kandidati për anëtar i Këshillit Drejtues, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas i Republikës së Shqipërisë;
- b) të jetë diplomuar në nivel master në shkencat ekonomike ose juridike;
- c) të ketë jo më pak se 7 vjet përvojë profesionale në fushën e sistemit bankar dhe/ose financiar dhe/ose institucionet publike shtetërore;
- ç) të ketë mbajtur një pozicion drejtues për të paktën 3 vjet në institucione financiare dhe/ose të kontrollit financiar që veprojnë në tregun financiar të brendshëm ose të jashtëm dhe/ose në institucionet publike shtetërore.
- d) të jetë me integritet profesional;
- dh) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- e) të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjykatë të formës së prerë;
- ë) të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Kandidati për anëtar i Këshillit Drejtues, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, nuk mund të jetë:

- a) ortak, aksioner, anëtar i organeve drejtuese, administrator, përfaqësues i subjekteve anëtare të skemës;
- b) në lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “a” të kësaj pike;
- c) punonjës me kohë të pjesshme ose të plotë i subjekteve anëtare të skemës.

3. Banka e Shqipërisë vlerëson dokumentacionin sipas kërkesave të saj, nëse kandidatët për anëtar të Këshillit Drejtues, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, të Agjencisë plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Kriteret për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Drejtorin e Përgjithshëm duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës që këta persona janë në detyrë.

5. Banka e Shqipërisë refuzon kandidaturat për anëtarë të Këshillit Drejtues, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, nëse kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk përmbushen ose rezulton se kandidati në dokumentacionin e dorëzuar pranë Bankës së Shqipërisë, ka paraqitur të dhëna të rreme.

Neni 40
Këshilli Drejtues i Agjencisë

1. Këshilli Drejtues i Agjencisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, përfshirë këtu edhe Drejtorin e Përgjithshëm.

2. Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të jetë kryetar i Këshillit Drejtues.

3. Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen nga Banka e Shqipërisë, të propozuar si më poshtë:

- a) dy anëtarë nga Banka e Shqipërisë.
- b) dy anëtarë nga ministria përgjegjëse për financat.
- c) një anëtar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

4. Përveç Drejtorit të Përgjithshëm, anëtarët e Këshillit Drejtues nuk janë të punësuar nga Agjencia.

5. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Agjencisë, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, emërohen për një afat pesëvjeçar. Anëtarët e Këshillit Drejtues, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, mund të rizgjidhen, bazuar në treguesit e performancës të veprimtarisë së tyre. Datat e qëndrimit në detyrë të anëtarëve janë të shpërndara gjatë periudhës pesëvjeçare.

Neni 41

Lirimi nga detyra dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm

1. Çdo anëtar i Këshillit Drejtues, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, shkarkohet nga Banka e Shqipërisë me propozim të Këshillit Drejtues, në rast se:
 - a) nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 39, pikat 1 dhe 2 të këtij ligji.
 - b) ka munguar tri ose më shumë herë, në vazhdimësi, në mbledhjet e radhës së Këshillit Drejtues, pa shkak të arsyeshem.
 - c) bëhet fizikisht ose mendërisht i paaftë për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar.
 - ç) shkel rëndë etikën dhe cënon interesat e Agjencisë.
 - d) gjatë ushtrimit të funksioneve vepron në kundërshtim me detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit.
2. Propozimi i Këshillit Drejtues të Agjencisë për shkarkimin e anëtarit të Këshillit Drejtues ose të Drejtorit të Përgjithshëm merret me shumicë të kualifikuar të votave të anëtarëve të Këshillit Drejtues.
3. Anëtari i Këshillit Drejtues, me përjashtim të rastit të Drejtorit të Përgjithshëm, lirohet nga detyra kur institucioni propozues i kërkon Bankës së Shqipërisë lirimin nga detyra të tyre, kur jep dorëheqjen ose vdes.
4. Agjencia njofton me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe institucionet përkatëse propozuese për përfundimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues, jo më vonë se tre muaj përpara datës së përfundimit të mandatit.
5. Anëtari i emëruar për të plotësuar një vend vakant të krijuar si pasojë e përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit paraardhës, e ushtron funksionin për një mandat të plotë pesëvjeçar.

Neni 42

Mbledhjet e Këshillit Drejtues

1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues kryesohen nga Kryetari. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjedhin si Kryetar njërin nga anëtarët që përfaqësojnë Bankën e Shqipërisë në këtë Këshill. Kryetari i Këshillit Drejtues nuk është Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.
2. Këshilli Drejtues mbledhet sa herë që kërkohet për realizimin e veprimtarisë së Agjencisë, por jo më pak se një herë në dy muaj kalendarikë. Këshilli Drejtues mbledhet me kërkesë të kryetarit, të Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe me kërkesën e jo më pak se dy anëtarëve të Këshillit Drejtues.
3. Çdo anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtën e një vote. Mbledhja e këtij këshilli zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve.
4. Përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në statutin e Agjencisë, vendimet e Këshillit Drejtues miratohen me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të tij, të cilët janë të pranishëm në mbledhje. Vetëm anëtarët e Këshillit Drejtues, që janë personalisht të pranishëm, kanë të drejtën e votës. Si përjashtim nga ky rregull, statuti i Agjencisë mund të lejojë që në mbledhjet e Këshillit Drejtues votimi të kryhet me mjete të tjera komunikimi. Në rast barazie vote, kryetari i mbledhjes ka votën përcaktuese.

5. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me votim të hapur, përveç rasteve kur bëhet votim për persona dhe kur Këshilli vendos ndryshe. Në votim nuk lejohet abstenimi.
6. Për çdo mbledhje të Këshillit Drejtues mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga anëtarët dhe sekretari i Këshillit Drejtues. Sekretari nuk është anëtar i Këshillit Drejtues dhe është punonjës i Agjencisë.
7. Këshilli Drejtues mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhjet e tij përfaqësues të anëtarëve të skemës, me qëllim dhënien e informacionit dhe/ose shprehjen e mendimeve për çështje që gjykohen të arsyeshme nga Këshilli.

Neni 43

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ka kompetencat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) garanton zbatimin e legjislacionit nga Agjencia;
- b) miraton rregulloret për administrimin e rrezikut, ndaj të cilit Agjencia ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;
- c) miraton rregulloret për krijimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për veprimtarinë e Agjencisë;
- ç) miraton statutin, rregulloret e brendshme dhe planet strategjike e vjetore të veprimtarisë së Agjencisë;
- d) propozon në Bankën e Shqipërisë shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- dh) propozon në Bankën e Shqipërisë emërimin ose shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë;
- e) miraton kontratën tip menaxheriale që Agjencia nënshkruan me Drejtorin e Përgjithshëm, si dhe kontratën tip të punës, procedurat dhe kriteret e punësimit të punonjësve të Agjencisë;
- ë) mbikëqyr veprimtarinë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe shqyrton raportet e tij mbi administrimin e veprimtarisë së Agjencisë;
- f) miraton strukturën organizative, numrin e punonjësve dhe përshkrimet e punës të punonjësve të Agjencisë;
- g) miraton projektbuxhetin e Agjencisë;
- gj) miraton politikën e trajtimit financiar për punonjësit e Agjencisë, si dhe anëtarët e Këshillit Drejtues në përputhje me nenin 45 të këtij ligji;
- h) miraton planin e pensionit vullnetar për personelin;
- i) vendos për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë;
- j) miraton kriteret për përzgjedhjen e audituesit të brendshëm të Agjencisë në rast të kryerjes së shërbimit të auditimit të brendshëm me kontraktim, ose emëron drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm, kur ka një të tillë të parashikuar në strukturën organizative të Agjencisë.
- k) miraton planet strategjike dhe vjetore për veprimtarinë e auditimit të brendshëm, si dhe shqyrton raportet e tij;
- l) miraton kriteret për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të specializuar të Agjencisë;
- ll) mbikëqyr mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen e raporteve financiare e statistikore të Agjencisë dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe garanton vërtetësinë dhe saktësinë e këtyre të dhënave, në përputhje me rregullat e metodat e përcaktuara;
- m) miraton pasqyrat financiare vjetore, raportin vjetor dhe raportet e tjera financiare të Agjencisë dhe të fondeve që ajo administron;
- n) miraton metodat për shpërndarjen e shpenzimeve lidhur me veprimtarinë e Agjencisë;
- nj) vendos për burime financiare shtesë të fondeve të sigurimit të depozitave;
- o) autorizon Drejtorin e Përgjithshëm për t'i paraqitur ministrisë përgjegjëse për financat kërkesën

për garanci shtetërore ose hua nga buxheti i shtetit, ose kërkesën për hua nga subjekte të tjera, si dhe njofton për këtë Bankën e Shqipërisë;

p) miraton huatë, garancitë, subvencionet dhe donacionet e marra nga Agjencia për kryerjen e veprimtarisë së saj, si dhe autorizon Drejtorin e Përgjithshëm për nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse;

q) miraton nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet e tjera brenda vendit, si dhe me skema të tjera të ngjashme të vendeve anëtare ose të vendeve të treta, si dhe autorizon Drejtorin e Përgjithshëm për nënshkrimin e marrëveshjeve përkatëse;

r) përcakton çdo vit kontributet vjetore të primeve të bazuara në rrezik për institucionet e kreditit anëtare të skemës, kontributet fillestare dhe kontributet e jashtëzakonshme në përputhje me këtë ligj;

rr) përcakton nivelin e synuar të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit, si dhe afatin për arritjen e tij;

s) propozon për miratim në Bankën e Shqipërisë aktin nënligjor për metodologjinë e llogaritjes së nivelit të synuar të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit;

sh) propozon për miratim në Bankën e Shqipërisë aktin nënligjor për metodologjinë e llogaritjes së kontributeve vjetore të primeve të bazuara në rrezik për institucionet e kreditit anëtare të skemës;

t) miraton ose refuzon dhënien e vërtetimit të përmbushjes së kushteve për anëtarësimin në skemë;

th) anëtarëson ose përjashton anëtarët nga skema;

u) miraton masat parandaluese që Agjencia ushtron ndaj anëtarëve, sipas nenit 68 të këtij ligji dhe aktet nënligjore të tij, dhe propozon në Bankën e Shqipërisë vendosjen e gjobave ose masave administrative ndaj anëtarëve, sipas dispozitave të këtij ligji;

v) vendos për kompensimin e depozitave të siguruara, sipas dispozitave të këtij ligji;

x) vendos për krijimin e komiteteve të specializuara;

xh) vendos për kthimin e fondit të sigurimit të depozitave në mjete likuide, për të përmbushur detyrimet ndaj depozituesve, në rast ngjarje sigurimi;

y) propozon për miratim në Bankën e Shqipërisë aktin nënligjor që përcakton rregullat dhe procedurat për kontraktim për përgatitjen dhe kryerjen e funksioneve të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi;

z) miraton strategjinë e informimit të publikut;

zh) autorizon Drejtorin e Përgjithshëm për të nënshkruar marrëveshjet e huasë për llogari të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” sipas vendimit të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Vendimet e Këshillit Drejtues që kanë efekt për anëtarët e skemës botohen në Fletoren Zyrtare.

3. Aktet e Këshillit Drejtues janë objekt ankimi drejtpërdrejt në gjykatë.

Neni 44

Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, i cili duhet të jetë një nga anëtarët e Këshillit Drejtues që përfaqëson Bankën e Shqipërisë, emërohet dhe shkarkohet nga Banka e Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues.

2. Drejtori i Përgjithshëm vepron si drejtor ekzekutiv i Agjencisë. Të drejtat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm rregullohen në statutin e Agjencisë.

3. Në rast se Drejtori i Përgjithshëm mungon, është në pamundësi për të vepruar, ose pozicioni i tij i punës është vakant, zëvendësuesi i përgjithshëm vepron në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë.

4. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të Këshillit Drejtues, mund të delegojë disa nga

kompetencat e tij zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Agjencisë.

5. Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet përpara Këshillit Drejtues për zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të Agjencisë.

6. Drejtori i Përgjithshëm nënshkruan me Agjencinë kontratë menaxheriale. Ai gëzon të gjitha përfitimet e kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore pranë Agjencisë.

7. Drejtori i Përgjithshëm i propozon Këshillit Drejtues, ndër të tjera:

a) projektaktet nënligjore që paraqiten për miratim në Këshillin Drejtues ose propozohen për miratim në Bankën e Shqipërisë;

b) nisjen e procedurave pranë autoriteteve përkatëse për iniciativat ligjvënëse dhe rregullatore të skemës;

c) vendimin për pagesën e kompensimit depozituesve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) vendimin për pranimin dhe përjashtimin nga skema të anëtarëve;

d) vendimin për propozimin në Bankën e Shqipërisë të gjobave ose masave administrative ndaj anëtarëve të skemës;

dh) vendimin për plotësimin e mjeteve financiare të disponueshme të fondeve të sigurimit të depozitave dhe miratimin e kërkesës drejtuar ministrisë përgjegjëse për financat për garanci shtetërore ose hua nga buxheti i shtetit, ose kërkesës për hua nga subjekte të tjera;

e) miratimin e bilancit vjetor, raportit vjetor dhe raporteve të tjera financiare të Agjencisë dhe të fondeve që ajo administron;

ë) projektbuxhetin e Agjencisë;

f) nivelin dhe strukturën e pagave dhe shpërblimeve, trajtime të tjera financiare si dhe përfitimet për punonjësit e Agjencisë.

8. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë kryen funksione nëse ato nuk janë parashikuar shprehimisht si funksione të Këshillit Drejtues, dhe në veçanti ka këto kompetenca:

a) vepron në emër të Agjencisë dhe përfaqëson interesat e saj pa autorizim të veçantë në marrëdhëniet me organet e qeverisjes qendrore e vendore, subjektet publike dhe private, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, subjektet përgjegjëse të mbikëqyrjes dhe të sigurimit të depozitave;

b) drejton administrimin e Agjencisë dhe organizon përmbushjen e vendimeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë;

c) emëron dhe shkarkon punonjësit e Agjencisë;

ç) bën shpërndarjen e detyrave dhe funksioneve ndërmjet punonjësve të Agjencisë;

d) merr vendim për ankesat e depozituesve në rast ngjarje siguri.

9. Aktet e Drejtorit të Përgjithshëm janë objekt ankimi drejtpërdrejt në gjykatë.

10. Drejtori i Përgjithshëm lirohet nga detyra në këto raste:

a) kur jep dorëheqjen ose vdes;

b) në datën e përfundimit të mandatit si anëtar i Këshillit Drejtues.

11. Drejtori i Përgjithshëm, pas largimit nga kjo detyrë me përfundimin e mandatit, nuk duhet të punësohet në një nga anëtarët e skemës, gjatë një periudhe prej një viti nga data e largimit nga detyra.

12. Personi që ka qenë i emëruar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm dhe i ka mbaruar mandati, pas largimit nga detyra, përfiton një vit nga e drejta për shpërblim në vlerën e pagës që ka pasur, kur ka qenë në detyrë. Nga kjo e drejtë nuk përfiton individ i riemëruar si Drejtor i Përgjithshëm, si dhe ai që është shkarkuar nga detyra sipas nenit 41, pika 1 e këtij ligji.

Neni 45
Organizimi dhe trajtimi i personelit

1. Veprimtaria e Agjencisë mbështetet nga personeli i saj. Marrëdhëniet e punësimit të personelit të Agjencisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në rekrutimin, largimin nga puna, të drejtat dhe detyrimet, rregullohen nga ky ligj, Kodi i Punës, si dhe rregulloret e miratuara nga Këshilli Drejtues i Agjencisë dhe nuk i nënshtrohen legjislacionit për shërbimin civil.
2. Këshilli Drejtues i Agjencisë përcakton politikën e trajtimit financiar të punonjësve të Agjencisë dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues, që rregullon nivelin dhe strukturën e pagave, shpërblimet, trajtimet e tjera financiare dhe përfitimet. Në përcaktimin e kësaj politike, Këshilli Drejtues duhet të marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e funksioneve të Agjencisë, përvojat e autoriteteve të tjera, që kryejnë aktivitetin e rregullatorit financiar në Shqipëri, nivelin e përgjegjësisë, nevojën për të ruajtur konkurrueshmërinë në tregun e punës, si dhe objektivin për të punësuar profesionistë të kualifikuar.
3. Këshilli Drejtues i Agjencisë rishikon periodikisht nivelet e pagave, shtesave dhe përfitimeve të tjera financiare. Paga bazë e personelit indeksohet çdo vit me normën vjetore të inflacionit.
4. Agjencia krijon një plan të pensionit vullnetar për personelin, në përputhje me legjislacionin për pensionet vullnetare. Agjencia kontribuon në planet e pensionit vullnetar për personelin.

Neni 46
Konflikti i interesit

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm dhe punonjësit e Agjencisë shmangin për aq sa është e mundur, interesin privat, i cili krijon konflikt me interesin e Agjencisë. Nëse ata kanë interesa private, që ndikojnë gjykimin e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve në Agjenci, duke krijuar konflikt interesi, bëjnë deklarinë e tyre pranë eprorit përkatës, në rastet e përcaktuara me ligje të Republikës së Shqipërisë.
2. Kurdoherë që shtrohen për diskutim në Këshillin Drejtues çështje në lidhje me të cilat anëtari ka interesa, atëherë ky anëtar deklaron interesat në fillimin e diskutimit dhe nuk merr pjesë në diskutimin e vendimit për këtë çështje. Prania e këtij anëtari llogaritet për efekt të kuorumit në mbledhje.
3. Rregullimi i rasteve të konfliktit të interesit në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave në çdo rast bëhet në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

Neni 47
Mbrojtja ligjore gjatë ushtrimit të detyrës

1. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, Agjencia, anëtarët e Këshillit Drejtues, personat që janë ose kanë qenë të punësuar, apo të kontraktuar që të veprojnë në emër dhe interes të Agjencisë, nuk mbajnë përgjegjësi civile ose administrative për dëmet e shkaktuara gjatë kryerjes së detyrave të tyre në përputhje me këtë ligj, legjislacionin e zbatueshëm dhe aktet nënligjore përkatëse, përveç rasteve kur provohet se një veprim i caktuar është bërë me qëllim ose me pakujdesi të rëndë.
2. Agjencia mbulon paraprakisht shpenzimet e përfaqësimit dhe të mbrojtjes ligjore të personave, sipas pikës 1 të këtij neni, në procedimet e ngritura ndaj tyre në lidhje me kryerjen e detyrave në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
3. Dispozitat e legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore nuk zbatohen për të përcaktuar përgjegjësinë jashtëkontraktore të

Agjencisë, si dhe të organeve apo personave të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 48

Konfidencialiteti

1. Agjencia siguron ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të depozituesve dhe të anëtarëve të skemës, duke e përdorur informacionin dhe të dhënat e marra vetëm për qëllim të ushtrimit të funksioneve në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Asnjë person që shërben ose ka shërbyer si anëtar i Këshillit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, punonjës i Agjencisë dhe personat të kontraktuar ose të autorizuar nga Agjencia nuk duhet që në mënyrë të paautorizuar:
 - a) të lejojë zbulimin ose publikimin e të dhënave jopublike që përbëjnë sekret profesional, të cilat janë përfituar nga kryerja e detyrave në Agjenci;
 - b) të përdorë ose të lejojë që këto të dhëna të përdoren për përfitime personale.
3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit, sipas këtij neni, nuk pengon dhënien e informacionit Agjencisë së Inteligjencës Financiare, organit të prokurorisë dhe gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VII

Administrimi i fondeve nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave

Neni 49

Fondet e Agjencisë

1. Fondet e Agjencisë përfshijnë fondin për sigurimin e depozitave në institucionet e kreditit dhe fondin për sigurimin e depozitave në SHKK-të. Çdo fond përbën grup të veçantë aktivesh të dallueshme qartë nga njëri-tjetri dhe përdoret ekskluzivisht për të përmbushur objektivat dhe funksionet e skemës. Fondet për sigurimin e depozitave në institucionet e kreditit dhe SHKK mbahen në llogari të ndara.
2. Fondet e sigurimit të depozitave, për qëllime të këtij ligji, përfshijnë fondet themeltare dhe fondet e tjera të akumuluar nga veprimtaria e Agjencisë.
3. Fondet e akumuluar rriten ose pakësohen me fitimet ose humbjet nga veprimtaria e Agjencisë.
4. Në rast ngjarje sigurimi, Këshilli Drejtues i Agjencisë mund të miratojë dhënien e huasë midis fondeve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, për të plotësuar pamjaftueshmërinë e mjeteve financiare të disponueshme të tyre. Mënyra dhe kriteret e huasë përcaktohen me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.
5. Këshilli Drejtues i Agjencisë njofton Bankën e Shqipërisë për vendimin e tij për dhënien e huasë midis fondeve.

Neni 50

Fondet themeltare të Agjencisë

1. Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në institucionet e kreditit është në vlerën 400 000 000 (katërqind milionë) lekë dhe është kontribut i buxhetit të shtetit.
2. Fondi themeltar për sigurimin e depozitave në SHKK është 76 000 000 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë) lekë dhe është kontribut i buxhetit të shtetit.
3. Fondet themeltare të Agjencisë mund të rriten, ose fonde të reja themeltare mund të krijohen me

hyrjen në fuqi të skemave të reja, vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, brenda kufijve të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit. Ndryshimi i niveleve të mbulimit, sipas nenit 19 të këtij ligji, nuk përbën zgjerim të skemës për qëllim të kësaj pike.

Neni 51

Burimet e fondeve

1. Burimet e fondeve të Agjencisë përfshijnë:

- a) kontributet fillestare të anëtarëve të rinj të skemës;
- b) kontributet vjetore të primit nga institucionet e kreditit anëtare të skemës;
- c) kontributet tremujore të primit nga SHKK-të anëtare të skemës;
- ç) kontributet e jashtëzakonshme nga anëtarët e skemës;
- d) rimarrje nga likuidimet në rast ngjarje sigurimi;
- dh) të ardhurat e përfituara nga veprimtaria investuese;
- e) huatë, subvencionet dhe donacionet. Huatë mund të garantohen nëpërmjet aktiveve ose pretendimeve të ardhshme të Agjencisë ose me një garanci të lëshuar nga Shteti Shqiptar në përputhje me legjislacionin për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore;
- ë) të ardhura të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

2. Agjencia informon Bankën e Shqipërisë për burimet e reja financiare, në përputhje me këtë ligj.

3. Burimet financiare të Agjencisë, sipas pikës 1, shkronjat “a” deri “d” të këtij neni, paguhet në lekë në llogaritë përkatëse të Agjencisë pranë Bankës së Shqipërisë.

Neni 52

Mjete financiare të disponueshme

1. Mjetet financiare të disponueshme të secilit fond duhet të jenë proporcionale me detyrimet e Agjencisë.

2. Mjetet financiare të disponueshme të Agjencisë nuk përfshijnë shpenzimet aktuale përkatëse të Agjencisë të buxhetuara, për vitin e fundit financiar, dhe kostot që lidhen me procesin e ngjarjes së sigurimit.

Neni 53

Niveli i synuar i fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit

1. Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton nivelin e synuar të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe afatin për arritjen e tij. Niveli i synuar i fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit, në çdo rast, nuk duhet të jetë më pak se 0.8% e shumës së depozitave të siguruara në institucionet e kreditit anëtare të skemës.

2. Për qëllim të llogaritjes së nivelit të synuar të fondit të sigurimit të depozitave, do të merren në konsideratë vetëm fondet themeltar, mjetet financiare të disponueshme të kontribuara drejtpërdrejt nga institucionet e kreditit anëtare të skemës dhe fondet e rimarra nga institucionet e kreditit anëtare të skemës, minus shpenzimet administrative të Agjencisë, sipas nenit 52, pika 2 të këtij ligji. Këto mjete financiare të disponueshme duhet të përfshijnë të ardhurat nga investimet e kontributeve të institucioneve të kreditit anëtare, si dhe fondet e rimarra nga Agjencia në rast ngjarje sigurimi, duke përjashtuar pagesat e shumave të kompensimit të papretenduara nga depozituesit, si dhe çdo detyrim huaje që duhet paguhet nga Agjencia. Në rast të huasë midis fondeve, sipas nenit 49, pika 4 të këtij ligji, mjetet financiare të dhëna hua duhet të përfshihen dhe

të llogariten ekskluzivisht drejt këtij niveli të synuar të fondit.

3. Banka e Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, miraton metodologjinë e llogaritjes së nivelit të synuar të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit.

4. Në rast se niveli i synuar i fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit, bie nën dy të tretat e nivelit të synuar, të miratuar nga Këshilli Drejtues i Agjencisë, si pasojë e rritjes së depozitave të siguruar ose të një ngjarje sigurimi, atëherë kontributet vjetore të primit që do të paguhet duhet të mundësojnë që ky nivel të arrihet maksimumi brenda 6 viteve.

5. Kur niveli i synuar i fondit, i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, është arritur për herë të parë dhe mjetet financiare të disponueshme të Agjencisë janë zvogëluar me më pak se një të tretën e nivelit të synuar të fondit, Agjencia do të përcaktojë kontributin vjetor të primit në masën që lejon që niveli i synuar i fondit të arrihet brenda dy viteve. Agjencia mund të zgjasë këtë periudhë me një vit tjetër për të siguruar që shuma që do të mbledhet do të arrijë një vlerë që është proporcionale me kostot e pagesës së kontributeve.

6. Kur mjetet financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit tejkalojnë nivelin e synuar të këtij fondi, të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, sipas pikës 1 të këtij neni, Këshilli Drejtues mund të vendosë uljen e kontributit vjetor të primit, vazhdimin e pagesës së kontributeve vjetore të primit me qëllim ruajtjen e nivelit të synuar të fondit, ose ndërprerjen e përkohshme të pagesës së tij. Kur mjetet financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit bien nën nivelin e synuar, pagesa e kontributeve vjetore të primit duhet të rifillojë me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, të paktën derisa të arrihet përsëri niveli i synuar i fondit.

7. Agjencia vlerëson të paktën një herë në çdo pesë vjet përputhshmërinë e nivelit të synuar të fondit me objektivin publik të skemës së sigurimit të depozitave sipas këtij ligji.

Neni 54

Qëllimi i përdorimit të mjeteve financiare të disponueshme

Mjetet financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK përdoren vetëm për:

a) kompensimin e depozitave të siguruar në rast likuidimi të detyruar ose të padisponueshmërisë së depozitave në një anëtar të skemës, sipas dispozitave të këtij ligji.

b) pjesëmarrjen e Agjencisë me transferimin e mjeteve financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit ose SHKK, gjatë procedurave të likuidimit të detyruar të një anëtar të skemës, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, me legjislacionin për institucionet e kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre, si dhe me legjislacionin për SHKK-të në Republikën e Shqipërisë.

c) pjesëmarrjen e Agjencisë me transferimin e mjeteve financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit në përputhje me legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në institucionet e kreditit në Republikën e Shqipërisë.

ç) mbulimin e të gjitha shpenzimeve administrative, sipas shkronjave "a" dhe "c" të këtij neni.

d) mbulimin e të gjitha shpenzimeve administrative dhe financiare për aktivitetin e përditshëm të Agjencisë, sipas buxhetit të miratuar nga Këshilli Drejtues.

dh) shlyerjen e detyrimeve dhe kredive të marra nga Agjencia, sipas këtij ligji.

Neni 55

Investimi i mjeteve financiare të disponueshme

1. Mjetet financiare të disponueshme të Agjencisë investohen në përputhje me parimet e rrezikut

të ulët dhe diversifikimit.

2. Mjetet financiare të disponueshme investohen në përputhje me aktet e miratuara nga Këshilli Drejtues, të cilat përcaktojnë procedurat, kriteret dhe kufijtë për investimin e tyre.

3. Mjetet financiare të disponueshme të Agjencisë investohen vetëm në:

a) depozita në Bankën e Shqipërisë.

b) tituj, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë, në lekë dhe në monedhë të huaj.

c) tituj të emetuara nga qeveritë dhe bankat qendrore, të cilat vlerësohen si të investueshme nga agjenci për vlerësimin e rrezikut, të njohura ndërkombëtarisht.

ç) depozita ose tituj, të emetuara nga institucione financiare ndërkombëtare, të cilat vlerësohen si të investueshme nga agjenci për vlerësimin e rrezikut, të njohura ndërkombëtarisht.

d) tituj, të emetuara nga shoqëri aksionare ndërkombëtare, të cilat vlerësohen si të investueshme nga agjenci për vlerësimin e rrezikut, të njohura ndërkombëtarisht.

4. Mjetet financiare të disponueshme të Agjencisë, të cilat janë vendosur në Bankën e Shqipërisë, mbahen të ndara nga fondet e tjera për qëllime kontabiliteti dhe të jenë lehtësisht të disponueshme për përdorim nga Agjencia.

5. Me qëllim administrimin e mjeteve të saj financiare të disponueshme, Agjencia mund të lidhë marrëveshje me Bankën e Shqipërisë ose institucione ndërkombëtare për administrimin financiar, të cilat për llogari të Agjencisë investojnë mjetet e saj financiare, në përputhje me qëllimet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 56

Plotësimi i mjeteve financiare të disponueshme

1. Nëse mjetet financiare të disponueshme të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit ose të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK janë të pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet e Agjencisë ndaj depozituesve, në rast ngjarje sigurimi, Agjencia mund të plotësojë fondet nga burimet e mëposhtme:

a) pagesa e kontributit vjetor ose tremujor të primit përpara afatit nga anëtarët e skemës, në përputhje me nenin 21 dhe 22 të këtij ligji.

b) pagesa e kontributeve të jashtëzakonshme nga anëtarët e skemës, në përputhje me nenin 23 të këtij ligji.

c) huamarrje nga anëtarët e skemës ose nga burime të tjera të tregut. Kushtet dhe afatet që rregullojnë këto kredi përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

ç) huamarrje midis fondeve, në përputhje me nenin 49, pika 4 të këtij ligji.

d) hua ose garanci nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore. Huaja nga buxheti i shtetit përdoret vetëm në rast të ndodhjes së një ngjarje sigurimi, sipas nenit 3, pika 20, të këtij ligji dhe vetëm pasi të jenë ezauruar burimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, dhe “ç” të kësaj pike. Vlera maksimale e huasë ose e garancisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor. Interesi i huasë që do të jepet nuk duhet të jetë më i lartë se normat e interesit të titujve, me një maturitet të krahasueshëm, të emetuara nga Qeveria Shqiptare dhe të tregtueshme në Republikën e Shqipërisë. Ministria përgjegjëse për financat vlerëson kërkesën e Agjencisë për hua nga buxheti i shtetit dhe kur çmon se plotësohen kushtet e këtij ligji dhe të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ia paraqet atë Këshillit të Ministrave. Për dhënien e huasë ose të garancisë, ministria përgjegjëse për financat lidh një marrëveshje me Agjencinë dhe Bankën e Shqipërisë.

2. Në rast ngjarje sigurimi, Agjencia mund të marrë hua nga anëtarët e skemës ose nga burime të tjera të tregut, të cilat nuk garantohen nga buxheti i shtetit, përpara se të përdorë mjetet financiare të disponueshme, si dhe përpara se të mbledhë kontributet e jashtëzakonshme.
3. Agjencia do të shlyejë fondet e marra hua, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, nëpërmjet kontributeve nga anëtarët e skemës, në përputhje me këtë ligj.
4. Me qëllim sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, Agjencia, përveç veprimeve në tregjet financiare, mund t'i shesë Bankës së Shqipërisë me detyrim riblerjeje, titujt në të cilët janë investuar burimet e saj financiare. Agjencia lidh një marrëveshje të përhershme me Bankën e Shqipërisë, për këtë qëllim.

Neni 57

Kontabiliteti dhe raportimi financiar i Agjencisë

1. Agjencia mban llogari e regjistra financiarë të veçantë për fondin e sigurimit të depozitave për institucionet e kreditit dhe për fondin e sigurimit të depozitave për SHKK-të, të cilat në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të fondeve, në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me standardet ndërkombëtare.
2. Për qëllimet e aktivitetit të saj, Agjencia mban llogari në Bankën e Shqipërisë, në sistemin bankar në Shqipëri ose jashtë vendit. Agjencia përgatit pasqyrat financiare në fund të çdo viti financiar.
3. Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 58

Auditimi

1. Pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë auditohen nga shoqëri audituese të pavarura, me reputacion të mirë dhe përvojë të njohur ndërkombëtare në auditimin e institucioneve të mëdha financiare.
2. Veprimtaria e Agjencisë auditohet nga auditues të brendshëm. Audituesi i brendshëm ushtron veprimtarinë e auditimit në përputhje me legjislacionin për auditimin e brendshëm në sektorin publik dhe aktet nënligjore të Agjencisë për këtë qëllim.

KREU VIII

Bashkëpunimi

Neni 59

Bashkëpunimi i Agjencisë me Bankën e Shqipërisë

1. Agjencia dhe Banka e Shqipërisë bashkëpunojnë për të përmbushur objektivat e tyre ligjorë, në veçanti, nëpërmjet:
 - a) nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, që përfshin shkëmbimin e të dhënave e të informacionit për anëtarët e skemës gjatë veprimtarisë së përditshme, si dhe në rast ngjarje sigurimi;
 - b) bashkëpunimit gjatë procesit të anëtarësimit të një subjekti në skemë ose të përjashtimit të një anëtar nga skema;
 - c) kryerjes së simulimeve, si dhe për përgatitjen dhe kryerjen e funksioneve të Agjencisë në rast ngjarje sigurimi.
 - ç) bashkëpunimit gjatë procesit të rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme në institucionet

e kreditit.

d) bashkërendimit të iniciativave ligjvënëse dhe rregullatore.

2. Agjencia informon Bankën e Shqipërisë lidhur me skemën e sigurimit të depozitave dhe gjendjen financiare të saj, me kërkesë të Bankës së Shqipërisë.

Neni 60

Bashkëpunimi i Agjencisë me ministrinë përgjegjëse për financat

1. Agjencia dhe Ministria përgjegjëse për financat bashkëpunojnë për identifikimin dhe vlerësimin e mekanizmave të mbështetjes së jashtëzakonshme financiare publike në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore.

2. Kur nga vlerësimet e Agjencisë rezulton se fondet e sigurimit të depozitave mund të mos jenë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve sipas këtij ligji, si pasojë e një ngjarjeje sigurimi ose e rrethanave që mund ta shkaktojnë atë, Agjencia njofton pa vonesë ministrinë përgjegjëse për financat dhe i vë në dispozicion informacionin e nevojshëm për vlerësimin e ekspozimit fiskal dhe të detyrimeve që mund të lindin për buxhetin e shtetit.

3. Agjencia dhe ministria përgjegjëse për financat lidhin marrëveshje për përdorimin e mbështetjes së jashtëzakonshme financiare publike për fondet e sigurimit të depozitave, nëpërmjet huasë ose garancisë shtetërore, në përputhje me nenin 56 të këtij ligji.

Neni 61

Simulimet

1. Agjencia kryen simulime të gatishmërisë së saj dhe të aftësisë së anëtarëve për të përmbushur detyrimet ndaj skemës. Simulimet duhet të bëhen të paktën çdo tre vjet dhe më shpesh kur është e nevojshme.

2. Anëtarët e skemës ruajnë në çdo kohë dhe i japin Agjencisë me kërkesë të saj të gjithë informacionin e nevojshëm për të kryer simulimet, në veçanti për përgatitjen për procesin e kompensimit, sipas depozitave të këtij ligji.

3. Agjencia do të përdorë informacionin e nevojshëm për kryerjen e simulimeve vetëm për qëllim të përmbushjes së proceseve të simulimeve, si dhe do të mbajë këtë informacion jo më shumë sesa kërkohet për realizimin e këtyre proceseve.

4. Agjencia merr pjesë në simulimet e organizuara nga anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare për parandalimin dhe administrimin e rreziqeve sistemike.

5. Agjencia siguron konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale që kanë të bëjnë me depozitat dhe depozituesit, sipas nenit 48 të këtij ligji.

Neni 62

Dega e një institucioni të kreditit të një shteti anëtar

1. Agjencia siguron depozitat e depozituesve, si vijon:

a) në degët e krijuara nga institucionet e kreditit anëtare të skemës, të cilat veprojnë në shtetet e tjera anëtare;

b) në institucionet e kreditit anëtare të skemës, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në shtete të tjera anëtare në përputhje me lirinë për të ofruar shërbime, siç përcaktohet në Titullin V, Kapitulli 3, të Direktivës 2013/36/BE, kur këta depozitues përdorin shërbimet në një shtet tjetër anëtar.

2. Depozituesit në degët e institucioneve të kreditit në një shtet anëtar tjetër do të kompensohen

nga skema e shtetit anëtar pritës, në emër të skemës së shtetit anëtar të origjinës. Skema e sigurimit të depozitave të shtetit anëtar pritës do të kryejë procesin e kompensimit, në përputhje me udhëzimet e skemës së sigurimit të depozitave të shtetit anëtar të origjinës. Skema e shtetit anëtar pritës nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi lidhur me veprimet e kryera, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga skema e shtetit anëtar të origjinës. Skema e shtetit anëtar të origjinës do të sigurojë financimin e nevojshëm, para kryerjes së pagesave të kompensimit dhe do të rimbursojë skemën e shtetit anëtar pritës për kostot e lidhura me këtë proces. Skema e shtetit anëtar pritës gjithashtu do të informojë depozituesit përkatës në emër të skemës së shtetit anëtar të origjinës dhe do të ketë të drejtë të marrë korrespondencë nga këta depozitues, në emër të skemës së shtetit anëtar të origjinës. Skema e shtetit anëtar të origjinës mund të vendosë që të paguajë depozituesit në degët që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëse përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

- a) barra administrative dhe kostoja e procesit të kompensimit është më e ulët, sesa nëse ky proces do të kryhej nga Agjencia;
- b) skema e shtetit anëtar të origjinës garanton që depozituesit të mos trajtohen në mënyrë më të pafavorshme, sesa nëse ky proces do të kryhej nga Agjencia;
- c) depozitat do të kompensohen në të njëjtën monedhë siç do të ishin kompensuar nëse ky proces do të kryhej nga Agjencia.

Agjencia, në cilësinë e skemës së shtetit anëtar pritës, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar me skemën e shtetit anëtar të origjinës, mund të veprojë si pikë kontakti për depozituesit e institucioneve të kreditit, të licencuara në shtetet anëtare të origjinës, por që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me lirinë për të ofruar shërbime, siç përcaktohet në Titullin V, Kapitulli 3, të Direktivës 2013/36/BE. Agjencia rimbursohet nga skema e shtetit anëtar të origjinës për kostot e lidhura me funksionin e pikës së kontaktit.

3. Skema e shtetit anëtar të origjinës dhe skema e shtetit anëtar pritës përkatës nënshkruajnë një marrëveshje, e cila përcakton kushtet dhe mënyrat e pagesës, duke përfshirë rimbursimin e çdo kostoje të lidhur me këtë proces, ushtrimin e funksioneve nga pika e kontaktit për depozituesit, afatin kohor dhe mënyrën e pagesës.

4. Në rast të pikave 2 dhe 3 të këtij neni, skema e shtetit anëtar të origjinës i jep Agjencisë, në cilësinë e skemës së shtetit anëtar pritës, informacion mbi:

- a) numrin e depozituesve në degët e institucioneve të kreditit, të licencuara në shtetin anëtar të origjinës, por që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, shumën e depozitave të siguruara në këto degë, si dhe çdo ndryshim në lidhje me këto të dhëna;
- b) numrin e depozituesve në institucionet e kreditit të licencuara në shtetet anëtare të origjinës, por që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në Titullin V, Kapitulli 3, të Direktivës 2013/36/BE, shumën e depozitave të siguruara në këto institucione, si dhe çdo ndryshim në lidhje me këto të dhëna.

Neni 63

Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit

1. Agjencia dhe autoritetet përgjegjëse nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për kompensimin e depozitave sipas nenit 62 të këtij ligji, në veçanti mbi kushtet dhe afatet e pagesës, duke përfshirë rimbursimin e çdo kostoje të lidhur me këtë proces, si dhe ushtrimin e funksionit të pikës së kontaktit për depozituesit, kohëzgjatjen e procesit dhe mënyrën e pagesës.

2. Përpunimi dhe transferimi i të dhënave personale në zbatim të këtij neni bëhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Agjencia njofton Autoritetin Bankar Evropian për çdo marrëveshje bashkëpunimi të lidhur me

autoritetin përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës.

4. Nëse Agjencia dhe autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar nuk arrijnë të nënshkruajnë një marrëveshje ose nëse lind një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e marrëveshjes së nënshkruar, çdo palë mund t'i drejtohet Autoritetit Bankar Evropian.

5. Agjencia dhe skemat e shteteve të tjera anëtare shkëmbejnë informacione në lidhje me mbikëqyrjen e anëtarëve, si dhe kryerjen e simulimeve. Informacioni që do të shkëmbehet për kryerjen e simulimeve do të përdoret vetëm për këtë qëllim, si dhe do të mbahet jo më shumë sesa kërkohet për realizimin e simulimeve.

Neni 64

Transferimi në një skemë tjetër sigurimi të depozitave në shtetet anëtare

1. Kur një institucion i kreditit anëtar i skemës largohet nga skema në Republikën e Shqipërisë, dhe i bashkohet skemës së një shteti anëtar tjetër, ose nëse disa nga aktivitetet e një institucioni të kreditit anëtar të skemës në Republikën e Shqipërisë, transferohen në skemën e një shteti anëtar tjetër, skema e shtetit anëtar të origjinës i transferon skemës së shtetit anëtar pritës, kontributet e këtij institucioni të kreditit anëtar të paguara në Agjenci, gjatë dymbëdhjetë muajve përpara ndryshimit të anëtarësimit ose të transferimit të aktivitetit, proporcionalisht me shumën e depozitave të siguruar të transferuara, me përjashtim të kontributeve të jashtëzakonshme, sipas nenit 23 të këtij ligji.

2. Skema e shtetit anëtar të origjinës, me kërkesë të skemës së shtetit anëtar pritës, i transferon kësaj të fundit, shumën e kontributeve sipas pikës 1 të këtij neni, brenda një muaji nga marrja e kësaj kërkesë.

3. Institucioni i kreditit anëtar i skemës në Republikën e Shqipërisë, i cili synon të transferohet në skemën e një shteti tjetër anëtar, duhet të njoftojë Agjencinë, të paktën gjashtë muaj përpara lidhur me këtë transferim. Gjatë kësaj periudhe, institucioni i kreditit anëtar është i detyruar të paguajë kontributin vjetor të primit, dhe kontributin e jashtëzakonshëm në Agjenci deri në përfundimin e anëtarësimit, në përputhje me nenet 21 dhe 23 të këtij ligji.

Neni 65

Dega e një institucioni të kreditit të një vendi të tretë

1. Dega që ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, por shoqëria mëmë e së cilës është themeluar në një vend të tretë, anëtarësohet në skemën e sigurimit të depozitave të Republikës së Shqipërisë, përpara se të fillojë aktivitetin e pranimit të depozitave. Këto degë paguajnë kontributet në skemën e Republikës së Shqipërisë sipas depozitave të këtij ligji.

Neni 66

Bashkëpunimi i Agjencisë me Autoritetin Bankar Evropian

1. Agjencia, brenda datës 31 mars të çdo viti, informon Autoritetin Bankar Evropian për:

- a) shumën e depozitave të siguruar nga skema e sigurimit të depozitave për datën 31 dhjetor të vitit paraardhës;
- b) shumën e mjeteve financiare të disponueshme për datën 31 dhjetor të vitit paraardhës, duke përfshirë huatë e marra ose të dhëna, nëse ka;
- c) afatin kohor brenda të cilit do të arrihet niveli i sunuar i fondeve, në rastet kur ka patur ngjarje sigurimi.

2. Agjencia njofton Autoritetin Bankar Evropian pa vonesë në rastet e mëposhtme:

- a) vendimin për ngjarjen e sigurimit;
- b) shuma e depozitave të siguruara, shuma e fondeve që Agjencia kërkohet të transferojë në rast ndërhyrje të jashtëzakonshme të institucioneve të kreditit, ose në rast likuidimi të detyruar të një anëtarit të skemës, shuma e fondeve të rimarra, kostot e Agjencisë për kryerjen e funksioneve të saj në këto procese, si dhe kohëzgjatjen e procesit të rimarrjes së fondeve;
- c) marrëveshjet e nënshkruara për plotësimin e mjeteve financiare të disponueshme, sipas nenit 63 të këtij ligji;
- ç) vendimin për mbylljen e skemës së sigurimit të depozitave ose krijimin e një skeme të re, për shkak të bashkimit të skemave ekzistuese ose të krijimit të një skeme ndërkufitare.

Neni 67

Bashkëpunimi i Agjencisë me organizatat ndërkombëtare

- 1. Agjencia nënshkruan marrëveshje anëtarësimi në organizata ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave.
- 2. Bashkëpunimi përfshin konsultime dypalëshe dhe shumëpalëshe, të shoqëruara me shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizave, i cili vlerësohet, rast pas rasti, i vlefshëm për interesa të përbashkëta në fushën e sigurimit të depozitave.
- 3. Në shkëmbimin e informacioneve Agjencia respekton kuadrin ligjor dhe nënligjor të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU IX

Masat parandaluese dhe ndëshkimore

Neni 68

Masat parandaluese

- 1. Agjencia merr masa parandaluese kundrejt anëtarëve të skemës, në rast të shkeljeve të këtij ligji, si dhe të akteve nënligjore për zbatimin e tij, në veçanti, kur anëtarit:
 - a) nuk paguan kontributin fillestar, kontributin vjetor ose tremujor të primit, dhe kontributin e jashtëzakonshëm, në masën dhe afatin e përcaktuar në këtë ligj;
 - b) nuk raporton ose raporton të dhënat dhe informacionin në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij;
 - c) raporton depozitat e siguruara, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji si dhe me aktet nënligjore të tij, për qëllim të llogaritjes së kontributit vjetor ose tremujor të primit;
 - ç) i jep Agjencisë të dhëna dhe informacione të pavërteta e të gabuara;
 - d) pengon kryerjen e procesit të verifikimit në ambientet e anëtarit të skemës;
 - dh) informon depozituesit dhe të tretët, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe udhëzimet e Agjencisë;
 - e) i regjistron të dhënat mbi depozitat në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë, duke penguar përcaktimin e saktë të shumës së kompensimit, që përfitohet nga depozituesi;
 - ë) nuk përmbush detyrimin dhe kushtet për sistemet elektronike në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij;
 - f) nuk raporton paraqitjen unike të depozituesit, në afatet e kërkuara nga Agjencia, në veçanti në rast ngjarjeje siguri;
 - g) nuk merr pjesë në kryerjen e simulimeve të procesit të kompensimit të depozitave, të organizuara nga Agjencia;

- gj) nuk bashkëvepron me anëtarët e tjerë dhe me Agjencinë për të ruajtur besimin në sistemin bankar dhe financiar, në rast ngjarje sigurimi;
2. Agjencia, në rast se vëren shkelje të anëtarëve, merr këto masa parandaluese:
- a) paralajmëron anëtarin për mosrespektimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe aktet nënligjore të tij;
- b) urdhëron anëtarin për pushimin e menjëhershëm të veprimeve të konsideruara si kundërvajtje dhe marrjen e masave korrigjuese;
- c) i jep anëtarit rekomandime për zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij.
3. Agjencia përcakton afatin për eliminimin e shkeljeve nga anëtari.
4. Anëtari, brenda afatit të përcaktuar nga Agjencia, i paraqet kësaj të fundit një raport të hollësishëm për masat e marra për eliminimin e shkeljeve.
5. Agjencia me marrjen e raportit, sipas pikës 4, të këtij neni, verifikon eliminimin e shkeljeve.
6. Agjencia merr vendim për të pranuar ose jo raportin mbi eliminimin e shkeljeve, brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e tij.
7. Në rast të vonesës në pagimin e kontributit vjetor ose tremujor të primit, anëtari paguan vlerën përkatëse të kontributit si dhe interesa, të barabartë me kredinë për mbështetje me likuiditet të Bankës së Shqipërisë, sipas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë.
8. Agjencia merr masa parandaluese, në përputhje me procedurën e përcaktuar në aktin nënligjor të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 69

Masa ndëshkimore

Në rast të shkeljeve të përsëritura të anëtarit, sipas përcaktimit të dhënë në pikën 1 të nenit 68, ose të refuzimit të raportit të anëtarit mbi eliminimin e shkeljeve nga Agjencia, Banka e Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, vendos ndaj anëtarëve të skemës gjoba ose masa administrative të parashikuara në legjislacionin mbi ushtrimin e veprimtarisë të institucioneve të kreditit dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të tyre dhe në legjislacionin për SHKK-të në Republikën e Shqipërisë.

KREU X

Dispozita të fundit

Neni 70

Aktet nënligjore

1. Agjencia i propozon Bankës së Shqipërisë miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi të tij.
2. Referencat e ligjeve të tjera ndaj ligjit 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, ose dispozitave të veçanta të tij, do të konsiderohen të bëra në këtë ligj, për aq sa është e mundur.
3. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, nëse nuk bien ndesh me dispozitat e këtij ligji.

Neni 71
Dispozita kalimtare

1. Dispozitat e këtij ligji në lidhje me kontributin vjetor të primit që duhet të paguhet nga institucionet e kreditit, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji, si dhe me nivelin e synuar të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji, hyjnë në fuqi më 1 korrik 2027. Primi për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2027 paguhet nga institucionet e kreditit anëtare të skemës sipas nenit 32, nenit 33, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 35 të ligjit 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, subjektet të cilët kanë më pak se një vit të anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave, nuk do të paguajnë primin e vitit të parë të aktivitetit, sipas dispozitave të ligjit nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
3. Nivelet e mbulimit për institucionet e kreditit, të përcaktuara në nenin 19, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të këtij ligji, hyjnë në fuqi në datën 1.07.2027.
4. Dispozitat për depozitat e përjashtuara, të përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji do të hyjnë në fuqi në datën 1.7.2027. Deri në këtë datë, mbeten në fuqi dispozitat për depozitat e përjashtuara të përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
5. Detyrimet e anëtarëve të skemës për paraqitjen unike të depozituesve, në zbatim të pikave 3 dhe 4 të këtij neni, do të hyjnë në fuqi në datën 1.7.2027.
6. Detyrimi i anëtarëve të skemës për evidentimin e depozitave të pranueshme për sigurim, i përcaktuar në nenin 13, pika 1, shkronja “dh” e këtij ligji do të hyjë në fuqi në datën 1.7.2027.
7. Detyrimi i anëtarëve të skemës për informimin e depozituesve nëpërmjet fletës informuese, i përcaktuar në nenin 15 të këtij ligji do të hyjë në fuqi në datën 1.07.2027. Deri në këtë datë, detyrimi i anëtarëve të skemës së sigurimit të depozitave për informimin e depozituesve do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
8. Mandatet e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe kontratat e punës të punonjësve të Agjencisë vazhdojnë të pandërprera, sipas afatit përkatës, pavarësisht nga shfuqizimi i ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.

Neni 72

Hyrja në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

1. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, hyjnë në fuqi neni 13, pika 1, shkronja “j”, neni 15, pika 8, neni 17, neni 25 pika 5, neni 62, neni 63, neni 64, neni 65 dhe neni 66 të këtij ligji.
2. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dispozitat e mëposhtme të këtij ligji ndryshojnë si vijon:
 - a) neni 2 i këtij ligji ndryshohet si vijon:
“1. Ky ligj zbatohet për:
 - a) institucionet e kreditit të licencuara në Republikën e Shqipërisë, si dhe për të gjitha degët e tyre në shtetet anëtare;
 - b) SHKK-të të licencuara në Republikën e Shqipërisë;
 - c) institucionet e kreditit, të licencuara në Republikën e Shqipërisë që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me lirinë për të ofruar shërbime, siç përcaktohet në Titullin V, Kapitulli 3, të Direktivës

2013/36/BE, depozituesit e të cilave përfitojnë shërbimet e tyre në shtetet e tjera anëtare;
ç) degët e institucioneve të kreditit të vendit të tretë që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për degën e institucionit të kreditit të licencuar në Republikën e Shqipërisë, por që ushtron veprimtarinë në një vend të tretë. Në mënyrë përjashtimore, Agjencia mund të sigurojë depozitat e këtyre degëve, me kusht që këto degë t'i paguajnë Agjencisë kontributet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe që Agjencia të ketë marrë miratimin për këtë qëllim nga Banka e Shqipërisë.”

b) Neni 15, pika 5 e këtij ligji ndryshohet si vijon:

“Anëtarët e skemës e bëjnë të disponueshëm, informacionin e përmendur në këtë nen, në gjuhën për të cilën është rënë dakord ndërmjet depozituesit dhe anëtarit të skemës, kur është hapur depozita, ose në gjuhën ose gjuhët zyrtare të shtetit anëtar në të cilin është themeluar dega.”

c) Në nenin 19, pika 1, pika 2 dhe pika 3, shkronja “a” e këtij ligji ndryshohet si vijon:

“1. Niveli i mbulimit në rast ngjarje sigurimi është në vlerën ekuivalente në lek e shumës deri në 100.000 (njëqind mijë) euro për depozitat e agreguara të çdo depozituesi në një anëtar të skemës.

2. Agjencia kompenson depozitat e individëve me balancë të përkohshme, me një mbulim mbi nivelin e mbulimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në vlerën ekuivalente në lek të shumës prej 500.000 (pesëqind mijë) euro, nëse fondet janë transferuar në llogari në një anëtar të skemës, gjatë një periudhe jo më shumë se gjashtë muaj pasi kjo shumë të jetë kredituar ose nga momenti kur depozitat e tilla bëhen ligjërish të transferueshme.

3. Depozitat me balancë të përkohshme, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, janë depozitat, të cilat burojnë nga:

a) transaksionet e një individi për pasuri të paluajtshme për banim, si dhe depozitat e destinuara për transaksione të tilla, me kusht që këto transaksione të jenë përfunduar ose synohen të përfundohen, në një afat të shkurtër, siç përcaktohet me akt nënligjor, si dhe me kusht që individi të paraqesë dokumentacionin që vërteton se transaksioni kishte përfunduar përpara datës së ngjarjes së sigurimit ose synohej të përfundohej në një afat të shkurtër.”

ç) Neni 21 i këtij ligji ndryshohet si vijon:

“Neni 21

Kontributet vjetore të primit për institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës

1. Institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës paguajnë kontributet vjetore të primit të bazuara në rrezik, të llogaritura në përpjesëtim me shumën e depozitave të siguruara të mbajtura në çdo institucion të kreditit ose SHKK anëtare, dhe me shkallën e rrezikut të marrë përsipër nga secili institucion i kreditit ose SHKK anëtare e skemës.

2. Detyrimi i institucioneve të kreditit dhe SHKK-ve anëtare për të paguar kontributin vjetor të primit shpërndahet në kohë, në mënyrë sa më të barabartë që të jetë e mundur, deri në arritjen dhe ruajtjen e niveleve të synuara të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, por duke marrë parasysh fazën e ciklit të biznesit dhe ndikimin prociklik që kontributet vjetore të primit mund të kenë ndaj institucioneve të kreditit dhe SHKK-ve anëtare të skemës.

3. Llogaritja e kontributeve vjetore të primit bazohet në mesataren e shumës së depozitave të siguruara të çdo institucioni të kreditit ose SHKK-je anëtare të skemës, në ditën e fundit të çdo tremujori për vitin paraardhës. Depozita e siguruar për çdo depozitues llogaritet duke agreguar

depozitat e pranueshme për sigurim, përfshirë edhe interesin e llogaritur deri në datën e raportimit, pavarësisht nga numri i depozitave apo monedha e tyre, deri në nivelin e mbulimit sipas nenit 19, pika 1 të këtij ligji.

4. Për depozitat e siguruara në valutë të huaj, konvertimi në lekë bëhet në bazë të kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për ditën e raportimit.

5. Për qëllim të llogaritjes së kontributit vjetor të primit, institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës raportojnë në sistemin informatik për raportim dhe kompensim të dhënat për depozitat e siguruara, sipas formatit standard të të dhënave të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

6. Agjencia merr nga Banka e Shqipërisë brenda datës 30 prill të çdo viti, të dhënat për treguesit e profilit të rrezikut të çdo institucioni të kreditit dhe SHKK-je anëtare të skemës, në përputhje me metodologjitë, të miratuara sipas pikës 9 të këtij neni.

7. Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton shumën përkatëse të kontributit vjetor të primit që duhet të paguajnë institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës. Agjencia brenda datës 30 qershor të çdo viti, do të informojë me shkrim secilin institucion të kreditit dhe SHKK anëtare të skemës mbi shumën e kontributit vjetor të primit që duhet të paguhet, për periudhën 1 korrik deri 30 qershor të vitit pasues. Kontributi vjetor i primit nga institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës do të paguhet në katër këste. Kësti i parë paguhet jo më vonë se data 31 korrik, ndërsa këstet e tjera jo më vonë se data 15 e muajit të parë të secilit tremujor pasues brenda periudhës për të cilën paguhet kontributi vjetor i primit.

8. Pagesa e kontributit vjetor të primit bëhet në lekë në llogarinë e Agjencisë, në Bankën e Shqipërisë.

9. Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë, Banka e Shqipërisë miraton metodologjitë për llogaritjen e kontributeve vjetore të primeve të bazuara në rrezik për institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës. Agjencia vlerëson të paktën një herë në pesë vjet, nëse këto metodologji kanë nevojë për rishikim.

10. Me propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe me miratimin e Bankës së Shqipërisë, institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës paguajnë para afatit kontributin vjetor të primit. Shuma e kontributit vjetor të primit të paguar para afatit nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e kontributit vjetor të primit të paguar për periudhën paraardhëse, në përputhje me nenin 56, pika 1, shkronja “a” të këtij ligji.

11. Nëse shuma e kontributit vjetor të primit të paguar para afatit ndryshon nga ajo e llogaritur sikur kontributi vjetor i primit të paguhej në afat, atëherë diferenca korrigjohet përkatësisht për periudhën pasardhëse për secilin institucion të kreditit ose SHKK.

12. Kontributi vjetor i primit për institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës, në rast të marrjes së huasë në përputhje me nenin 56 të këtij ligji, përllogaritet në mënyrë që të mundësojë shlyerjen e huasë, si dhe për të arritur nivelet e synuara të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit ose të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK.”

d) Neni 22 i këtij ligji, si dhe referenca e tij në nenin 56, pika 1 shkronja “a” shfuqizohet.

dh) Neni 26, pika 2 e këtij ligji ndryshohet si vijon:

“Agjencia duhet të mundësojë që shuma e kompensimit të jetë e disponueshme për depozituesit sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda 7 ditë pune nga data e miratimit të vendimeve të Bankës së Shqipërisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni”.

e) Neni 26, pika 3 e këtij ligji ndryshohet si vijon:

“Afati i pagesës së shumës së kompensimit për depozitat e përcaktuara në nenin 17, në nenin 19,

pika 2 dhe në nenin 25, pika 5 e këtij ligji është deri në 20 ditë pune nga data që depozituesi paraqet në Agjenci kërkesën dhe dokumentacionin e plotë që vërteton të drejtën e përfitimit të shumës së kompensimit.”

ë) Në nenin 43, pika 1, shkronjat “r”, “rr”, “s” dhe “sh” të këtij ligji ndryshohen si vijon:

“r) përcakton çdo vit kontributet vjetore të primeve të bazuara në rrezik për institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës, kontributet fillestare dhe kontributet e jashtëzakonshme në përputhje me këtë ligj;

“rr) përcakton nivelet e synuara të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, si dhe afatet për arritjen e tyre;”

“s) propozon për miratim në Bankën e Shqipërisë aktet nënligjore për metodologjitë e llogaritjes së niveleve të synuara të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK;”

“sh) propozon për miratim në Bankën e Shqipërisë aktet nënligjore për metodologjitë e llogaritjes së kontributeve vjetore të primeve të bazuara në rrezik për institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës;”

f) Në nenin 51 të këtij ligji bëhen ndryshimet e mëposhtme:

f.1) pika 1, shkronja “b” e këtij ligji ndryshohet si vijon:

“b) kontributet vjetore të primit nga institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës;”

f.2) pika 1 shkronja “c” shfuqizohet.

g) Neni 53 i këtij ligji ndryshohet si vijon:

“Neni 53

***Nivelet e synuara të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit
dhe të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK***

1. Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton nivelet e synuara të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, si dhe afatet për arritjen e tyre. Nivelet e synuara të fondit të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe të fondit të sigurimit të depozitave në SHKK, në çdo rast, nuk duhet të jenë më pak se 0.8% e shumës së depozitave të siguruar në institucionet e kreditit ose SHKK-të anëtare të skemës.

2. Për qëllim të llogaritjes së niveleve të synuara të fondeve të sigurimit të depozitave, do të merren në konsideratë vetëm fondet themeltare, mjetet financiare të disponueshme të kontribuara drejtpërdrejt nga institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës, dhe fondet e rimarra nga institucionet e kreditit dhe SHKK-të anëtare të skemës, minus shpenzimet administrative të Agjencisë, sipas nenit 52, pika 2 të këtij ligji. Këto mjete financiare të disponueshme duhet të përfshijnë të ardhurat nga investimet e kontributeve të institucioneve të kreditit dhe SHKK-ve anëtare, si dhe fondet e rimarra nga Agjencia në rast ngjarje sigurimi, duke përjashtuar pagesat e shumave të kompensimit të papretenduara nga depozituesit si dhe çdo detyrim huaje që duhet paguhet nga Agjencia. Në rast të huasë midis fondeve, sipas nenit 49, pika 4 të këtij ligji, mjetet financiare të dhëna hua duhet të përfshihen dhe të llogariten ekskluzivisht drejt nivelit të synuar të fondit përkatës nga i cili jepet huaja.

3. Banka e Shqipërisë, me propozim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, miraton metodologjitë e llogaritjes së niveleve të synuara të fondeve të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe SHKK-të.

4. Në rast se nivelet e synuara të fondeve të sigurimit të depozitave në institucionet e kreditit dhe SHKK-të, bien nën dy të tretat e nivelit të synuar të fondit përkatës, të miratuar nga Këshilli

Drejtues i Agjencisë, si pasojë e rritjes së depozitave të siguruara ose të një ngjarje sigurimi, atëherë kontributet vjetore të primit që do të paguhen duhet të mundësojnë që këto nivele të arrihen maksimumi brenda 6 viteve.

5. Kur niveli i synuar i fondit përkatës, i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, është arritur për herë të parë dhe mjetet financiare të disponueshme të këtij fondi janë zvogëluar me më pak se një të tretën e nivelit të synuar të tij, Agjencia do të përcaktojë kontributin vjetor të primit në masën që lejon që niveli i synuar i fondit përkatës të arrihet brenda dy viteve. Agjencia mund të zgjasë këtë periudhë me një vit tjetër për të siguruar që shuma që do të mbledhet do të arrijë një vlerë që është proporcionale me kostot e pagesës së kontributeve të institucioneve të kreditit ose të SHKK-ve.

6. Kur mjetet financiare të disponueshme të secilit prej fondeve të sigurimit të depozitave tejkalojnë nivelin e synuar përkatës, të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, sipas pikës 1 të këtij neni, Këshilli Drejtues mund të vendosë uljen e kontributit vjetor të primit, vazhdimin e pagesës së kontributit vjetor të primit me qëllim ruajtjen e nivelit të synuar të fondit përkatës, ose ndërprerjen e përkohshme të pagesës së tij. Kur mjetet financiare të disponueshme të secilit prej fondeve të sigurimit të depozitave, bien nën nivelin e synuar përkatës, pagesa e kontributeve vjetore të primit duhet të rifillojë me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, të paktën derisa të arrihet përsëri niveli i synuar i secilit fond.

7. Agjencia vlerëson të paktën një herë në çdo pesë vjet përputhshmërinë e niveleve të synuara të fondeve me objektivin publik të skemës së sigurimit të depozitave sipas këtij ligji.”

gj) Neni 56, pika 1 shkronja “d” e këtij ligji ndryshohet si vijon:

“d) hua ose garanci nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore. Huaja nga buxheti i shtetit përdoret vetëm në rast të ndodhjes së një ngjarje sigurimi, sipas nenit 3, pika 20, të këtij ligji, dhe vetëm pasi të jenë ezauruar burimet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të kësaj pike. Vlera maksimale e huasë ose e garancisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor. Interesi i huasë që do të jepet nuk duhet të jetë më i lartë se normat e interesit të titujve, me një maturitet të krahasueshëm, të emetuara nga Qeveria Shqiptare dhe të tregtueshme në Republikën e Shqipërisë. Agjencia shlyen fondet e marra hua brenda gjashtë vjetësh. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur Banka e Shqipërisë vlerëson se shlyerja e këtyre fondeve mund të mbingarkojë kapacitetet financiare të anëtarëve të skemës, periudha e shlyerjes mund të zgjatet vetëm një herë, jo më shumë se tre vjet. Ministria përgjegjëse për financat vlerëson kërkesën e Agjencisë për hua nga buxheti i shtetit dhe kur çmon se plotësohen kushtet e këtij ligji dhe të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ia paraqet atë Këshillit të Ministrave. Për dhënien e huasë ose të garancisë, ministria përgjegjëse për financat lidh një marrëveshje me Agjencinë dhe Bankën e Shqipërisë.”

h) Në nenin 4, shkronja “b”, në nenin 13, pika 1, shkronjat “a” dhe “c”, në nenin 14, pika 3, në nenin 24, në nenin 36, pika 1, shkronja “e”, në nenin 56, pika 1, shkronja “a”, në nenin 68, pika 1, shkronjat “a” dhe “c” dhe pika 7 të këtij ligji, togfjalëshi “ose tremujor” shfuqizohet.

Neni 73 Hyrja në fuqi

1. Ligji nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.